

**TOMORR PLANGARICA****MBI VENDIN DHE NATYRËN E PRURJEVE SHKENCORE  
TË GJUHËSISË SË ZBATUAR NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT**

Synimi për të shqyrtuar vendin dhe natyrën e prurjeve shkencore të gjuhësisë së zbatuar në shkencat e ligjërimit, pra synimi për të përcaktuar statusin e kësaj disipline në mendimin gjuhësor të tanishëm në raport me dijen e njohuritë e përvijuara në një fushë të caktuar të kërkimit shkencor (shkencat e ligjërimit), nuk është përpjekje për të përmbushur thjesht një kureshti intelektuale, por është, më së shumti, nxitje për të përcaktuar qëndrime në lidhje me dijet në atë fushë e, për më tepër, grishje për t'u futur në hapësira të cilat jo pak herë anashkalohen a shpërfillen: hapësira të natyrës epistemologjike a historike, por që i shërbejnë qartësisë të perspektivave të zhvillimit në të ardhmen. Ndodh jo rrallë që këto hapësira t'i kemi larg vëmendjes qoftë nga prirja për t'u përqendruar në atë çka është më drejtpërdrejt e kapshme në fushën e kërkimit për të cilën interesohemi, qoftë nga ngurrimi a mëdyshja që lind intuitivisht kur priremi të shpjegojmë marrëdhënie, lidhje a raporte të një disipline a të një dijeje me disiplina a dije të tjera, qoftë edhe nga fakti se përcaktimi i statusit të një disipline në tërësinë e fushës së kërkimit jo pak herë lë diçka të diskutueshme, të pasigurt në dinamikën që karakterizon zhvillimin e shqyrtimeve në një kohë të caktuar, sidomos kur bëhet fjalë për dije a disiplina të zbatuara.

Gjuhësia e zbatuar, një disiplinë e re, e institucionalizuar së voni në mendimin gjuhësor botëror, e njëherazi e pranishme si prirje dhe kërkesë e brendshme e shqyrtimeve gjuhësore në çdo kohë, disiplinë autonome, e njëherazi (meta-)disiplinë që përfshin një sërë (nën-)disiplinash që interesohen për ligjërimin e gjuhën, disiplinë e zbatuar, por që njëherazi përpunon teori gjuhësore në funksion të studimit të profileve të ndryshme të objektit të saj të studimit, nxit sot diskutime të llojeve të ndryshme të natyrës epistemologjike, si dhe mëtime ambicioze për të zgjidhur problemet që shoqëria e sotme has në përdorimin e gjuhës përgjatë komunikimit. Në mendimin tonë gjuhësor ritmet e zhvillimit të kësaj fushe studimi do të jenë në përputhje me kërkesat e kohës nëse do ta ndriçojmë sa më mirë këtë kontekst të zhvillimeve të sotme e nëse në mënyrë të vetëdijshme do t'u mundësojmë shqyrtimeve tona në këtë fushë institucionalizimin e plotë e të qëndrueshëm, me tërë infrastrukturën e nevojshme për këtë proces.

Zhvillimet e vullshme dhe prurjet e shumta nga përvojat e përfutuara në vende të ndryshme kërkojnë vëmendje e angazhim sa më të plotë të studiuesve dhe institucioneve të angazhuara në këtë fushë studimi. Ndryçimi sa më i plotë i kontekstit epistemologjik që mundësoi institucionalizimin e prurjeve shkencore të gjuhësisë së zbatuar, ndjekja e problematikës së larmishme që bëhet pjesë e veprimtarive shkencore dhe e revistave të specializuara ndërkombëtare e kombëtare për këtë fushë studimi, reflektimi ndaj debateve në to (pse jo edhe pjesëmarrja në ato debate, me përvojat e shqyrtimeve tona), do të na ndihmojnë të orientohemi më lehtë në njohjen dhe në zgjidhjen e problemeve që parashtrihen para kësaj fushe studimi në mjedisin tonë shkencor e social. Ndaj në parashtrimet që vijojnë, jemi përpjekur t'i ndriçojmë prurjet e gjuhësisë së zbatuar në ditët tona duke pasur parasysh edhe këto hapësira në të cilat ato janë mundësuar dhe vijojnë të zhvillohen aktualisht, me veçantitë që i kanë kushtëzuar kontekstet epistemologjike prej të cilave ato kanë lindur a janë nxitur.

• *Shkenca teorike - shkenca e zbatuar dhe gjuhësia e shkencat e ligjërimit*

Synimi për të përcaktuar statusin e një disipline shkencore a fushe studimi (siç është gjuhësia e zbatuar) në një hapësirë më të gjerë shkencore të përfaqësuar nga shkencat e ligjërimit (me prani të disiplinave mirëfilli teorike, por edhe të zbatuara), mund të jetë më i mbështetur nëse sqarohen paraprakisht domethëniet që bartin vetë emërtimet e këtyre disiplinave, emërtime që e drejtojnë interpretimin në përfaqesjen shkencë teorike – shkencë e zbatuar (meqenëse po flasim për një model a paradigmë të studimeve gjuhësore që merr cilësimin e zbatuar); nëse sqarojmë paraprakisht domethënien që merr emërtimi “gjuhësi” si shkencë teorike (nacion që karakterizohet nga një dinamikë që shpreh zhvillimet e brendshme brenda dijes që studion dukuritë gjuhësore, me objekt studimi e metodologji jo të njëjta nga një periudhë në tjetrën); e po ashtu nëse sqarojmë paraprakisht edhe domethënien e emërtimit tjetër “shkencat e ligjërimit” (që po zgjeron natyrshëm domethënien e emërtimit të gjuhësisë, sepse ka ndryshuar qasja ndaj objektit të studimit të saj, profileve e përmasave të tij, duke lënë emërtimin “gjuhësi” si një pjesë të shkencave të ligjërimit, me objektin klasik a më tradicional të shqyrtimeve në këtë fushë, e duke krijuar mundësi të përfshirjes në shkencat e ligjërimit edhe të dijeve të tjera të përfutuara nga disiplina shkencore që interesohen për ligjërimin a gjuhën<sup>1</sup>).

<sup>1</sup> Për të lehtësuar komunikimin në trajtimin e problematikës që lidhet me statusin e *gjuhësisë së zbatuar* në përbërje të *shkencave të ligjërimit* (ndërsa nocione të tilla si “ligjërim”, “gjuhë”, nxënie e përvetësim i gjuhës a ligjërimit, janë në qendër të interesimeve të gjuhëtarëve e studiuesve), përgjatë parashtrimeve të mëposhtme, për

Është e nevojshme pra një qasje epistemologjike në shqyrtim, për ta vendosur gjuhësinë e zbatuar përkrah disiplinave zbatuese; por po ashtu edhe një qasje epistemologjike e historike për të vërejtur më për nga afër dinamikën e veçantinë e zhvillimeve të brendshme e të jashtme në shqyrtimet teorike gjuhësore dhe kalimin e natyrshëm në emërtimin “shkencat e ligjërimit”, ku shumësia në emërtim do të parakuptojë njëherazi edhe një model a paradigmë të re shqyrtimi.

Gjuhësia moderne, disiplinë *in fieri* në kohën e Sosyrit, me vendndodhje e hapësira që po përcaktoheshin më saktë nga Sosyri e bashkëkohësit e tij në gjysmën e dytë të shekullit XIX e fillimin e shekullit XX, me qasje të rreptë epistemologjike e me themele të qëndrueshme të hedhura prej tij përmes “Kursit të gjuhësisë së përgjithshme” (1916) (gjithsesi, tekst “vulgate”, i botuar nga kolegët e tij, sipas shënimeve të studentëve të tij dhe jo vetë Sosyrit në gjallje), do të plotësohej në vijimësi si ngrehinë me të gjitha mjediset e domosdoshme për të studiuar dukuritë komplekse e shumëformëshe të shfaqjes së ligjërimit, për të studiuar jo vetëm gjuhën si produkt social i aftësisë ligjërimore, si “thesar” i ruajtur te subjektet folëse, por edhe aktin individual bashkë me fuqinë dhe efektin e tij të kushtëzuar nga subjekti i thënies e situata e komunikimit. Janë mjedise të bollshme të projektuara qysh në themele të ngrehinës, të lëna mënjanë në ato fillime nga “Kursi i gjuhësisë së përgjithshme” (por që nuk mbeteshin jashtë vëmendjes së Sosyrit, siç e tregojnë dëshmitë autentike, dorëshkrimet e tij të gjetura shumë më vonë e të botuara nga studiuesit e veprës së tij, ku del qartë se ai kishte qenë i vëmendshëm dhe kishte një vizion shumë më të gjerë në lidhje me objektin e gjuhësisë – le të kujtojmë sidomos F. De Saussure, “Écrits de linguistique générale”, Paris, Gallimard, 2002 [éd. Simon Bouquet et Rudolf Engler]<sup>2</sup>).

---

arsye metodologjike, kemi ruajtur praninë e të dyja skajeve: *ligjërimiti* (sipas traditës sosyriane, aftësia për të ngjizur komunikimin përmes mjeteve gjuhësore, aftësia për të folur, për të nyjtuar njësi të njëpasnjëshme, si fonemat, fjalët, frazat) dhe *gjuha* (produkti social i aftësisë ligjërimore, kodi i përbashkët për të gjithë pjesëtarët e një komuniteti gjuhësor që mundëson ushtrimin e kësaj aftësie nga individët, që është në opozicion me *të folurit*, që përftohet prej veprimit individual). Ky dallim është veçanti e trajtesave gjuhësore sidomos në gjuhësinë franceze. E. Benveniste-i theksonte: “[...]gjuhësia ka një objekt të dyfishtë, ajo është shkencë e ligjërimit dhe shkencë e gjuhëve. Ky dallim që nuk bëhet zakonisht, është i nevojshëm: ligjërimiti, aftësi njerëzore, karakteristikë universale dhe e pandryshueshme e njeriut, është i ndryshëm nga gjuhët, gjithnjë të veçanta e të ndryshme, përmes të cilave ai realizohet” (Benveniste, É 1966:19). Në gjuhësinë anglo-saksone, një fjalë e vetme, *language*, mbulon të dyja nocionet. Edhe në shqipe përgjithësisht *gjuhë* i mbulon të dyja nocionet.<sup>2</sup> Në një studim të tij për Sosyrin e sosyrizmin, të botuar më 2015-ën, François Rastier pohon: “Veçanërisht, më 1996, zbulimi i një dorëshkrimi të botuar më 2002-shin nën titullin “De l’essence double du langage” ka nxitur një zhvillim të vullshëm të

Këto mjedise që popullohen disi më vonë, bëhen edhe më domethënëse kur shfaqet në to edhe prania e Sosyrit; e në këto hapësira, gjuhësia e zbatuar do të vendosej natyrshëm, do të institucionalizohej, falë prurjeve e përvojave të përfutuara ndërkohë, por sidomos duke përfutuar e duke u nxitur nga ndriçimi që hidhnin ndaj profileve të ndryshme të objektit të saj zhvillimet në shkencat e ligjëritimit, ndaj profileve të pandriçuara sa duhet më parë, ose të padalluara si të tilla për mungesë ndriçimi.

- *Shkencat teorike dhe shkencat e zbatuara – modeli linear, kundërlinear dhe jolinear në bashkëmarrëdhëniet mes tyre*

Gjendja e studimeve a statusi i një disipline shkencore përcaktohet duke patur parasysh zhvillimet e brendshme në vetë dijet e përfutuara në fushën përkatëse të dijes e po ashtu edhe nga lidhjet e vendosura me disiplinat më pranë apo edhe më larg tyre. Në ditët tona shqyrtimi i statusit të dijeve në një fushë të caktuar studimi shfaqet më i ndërlikuar, ndërsa shumëdisiplinariteti, ndërdisiplinariteti apo edhe përtejdisiplinariteti (transdisiplinariteti)<sup>3</sup> është një dukuri karakterizuese e zhvillimit të sotëm të kërkimit shkencor. Të kësaj natyre janë në mënyrë të veçantë dijet e zbatuara (të cilat mund të perceptohen si të tilla përmes njërit prej kategorizimeve të dijes shkencore, në të cilin përqasen “shkenca a dije bazike (fondamentale), teorike” dhe “dije të

---

studimeve sosyriane”. [...] “Kursi i gjuhësisë së përgjithshme” minimizonte prurjen e Sosyrit në gjuhësinë e të folurit”. [...] “Sosyri autentik i “De l’essence” e tejkalon Sosyrin shkollor të “Kursit...”. [...] Megjithëse “Kursi...” e bën atë gabimisht një gjuhëtar të gjuhës, Sosyri është po aq, në mos më shumë, një teoricien i të folurit, dhe “Note sur le discours” janë në këtë rast një provë e dukshme”. [...] “Gjuhësia sosyriane mbetet revolucionare sepse është një gjuhësi e tekstit dhe jo një gjuhësi e shenjës: jo se ajo ka kërkuar të bëjë një “gramatikë të tekstit”, por ngaqë vetë përcaktimi i njëjësive gramatikore ka çuar në përmasën e tekstit ku këto njësi, përndryshe të zbrazëta dhe të papërcaktueshme, marrin vlerën e tyre” (Rastier, F., 2015:9, 17, 110, 177).

<sup>3</sup> Mes varianteve jo të pakta të përkufizimit të këtyre skajeve, në mënyrë tejet të përmbledhur, *shumëdisiplinariteti* (multidisiplinariteti, por edhe pluridisiplinariteti) që i korrespondon një pranëvënijeje të modeleve disiplinare, është një mënyrë studimi që përftohet nga shqyrtimi i të njëjtut problem prej shumë disiplinash; *ndërdisiplinariteti* parakupton një model të përbashkët të integruar të prejardhur prej disiplinave të ndryshme, pra përdorimin, bashkëshoqërimin dhe bashkërendimin e dijeve të disiplinave shkencore përmes trajtimit të integruar të problemeve; ndërsa *tejdisiplinariteti* (transdisiplinariteti) shkon përtej logjikës disiplinare, në sajë të prurjes së tipave të tjerë të njohurive jo vetëm shkencore; çon pra në një mënyrë trajtimi që përvijohet “duke i kapërcyer” disiplinat përkatëse që janë në lidhje të ngushtë, deri në përfutimin e një disipline të re (shih edhe Jean-Louis Fabiani, J.-L., 2006:11-34; Fourez, G. et al. 2002).

zbatuara”, krahas kategorizimeve të tjera të dijeve shkencore, si “shkenca logjiko-formale”, “shkenca natyrore”, “shkenca humane e sociale” etj.).

Dallimi mes shkencës së “pastër”, të “mirëfilltë”, bazike, teorike dhe shkencës së zbatuar qëndron në qasjen ndaj objektit të studimit, pra, në veçantinë e metodave të përdorura në shqyrtim dhe synimeve të parakuptuara në shqyrtimin e objektit real. Këto dy tregues të rëndësishëm mundësojnë më tej “të ndërtohet” objekti më i veçantë i shkencës së zbatuar nga lënda që është e përbashkët edhe për shkencën bazë, teorike (dhe për të cilën mund të interesohet si shkenca e zbatuar po ashtu edhe shkenca bazike, me synime teorike a përshkruese)<sup>4</sup>.

Jo pak herë, vetë emërtimi i fushës së caktuar të studimit a disiplinës shkencore e bart dhe e parakupton edhe nga emërtimi praninë e raportit të studiuesit me një realitet të veçantë, i cili i shndërrohet në objekt studimi (a të cilin e shndërron në objekt të njohjes); ndaj këto akte “pagëzimi” të fushave të studimit a disiplinave e ruajnë të shprehur hera-herës raportin njeri - objekt shqyrtimi “i ndërtuar” prej tij. Një pjesë e disiplinave ruajnë në emërtim (nga greqishtja e vjetër) përbërësin *logos*, pra fjalë, diskurs, shqyrtim etj. mbi një realitet të caktuar, që në këtë mënyrë shndërrohet në objekt shqyrtimi; apo *filo*, pra mik, që po ashtu priret të vendosë këtë lloj raporti në përcaktimin e asaj çka emërtohet me subjektin shqyrtues; apo *grafos*, pra shkrim, etj. Kjo marrëdhënie me objektin e shqyrtuar (duhet theksuar “të ndërtuar” nga subjekti/komuniteti shqyrtues dhe qasjes së studiuesit ndaj atij objekti) mundësoi në mjedisin shkencor disiplina shkencore<sup>5</sup> a fusha dijeje ku të dyja anët, teorike e praktike,

---

<sup>4</sup> Bëjmë dallimin mes emërtimeve *objekti real a lënda*, që nxitin shqyrtimet në një dije të caktuar, nga *objekti i studimit a objekti i njohjes* në dijen përkatëse. *Objekti real a lënda* ekziston pavarësisht nga studiuesi, ndërsa *objekti i njohjes a objekti i studimit* është “i ndërtuar” në procesin e studimit nga studiuesi. Në fushën e gjuhësisë me *objekt real* apo *lëndë* të gjuhësisë, qysh me përcaktimet e Sosyrit, do të parakuptojmë “tërësinë e manifestimeve të ligjërimit, që janë të larmishme, të ndryshme, shumëformëshe dhe, si të tilla, të pakapshme në tërësinë e tyre; ndërsa *objekti i gjuhësisë* është nënbashkësi e manifestimeve të ligjërimit që gjuhëtari “ndërton” duke përshtatur këtë apo atë pikëpamje, duke përzgjedhur të interesohet për këtë apo atë aspekt të lëndës. Nëse lënda është e dhënë paraprakisht, objekti i studimit si i tillë përftohet prej qasjesh a vendimesh të caktuara (Moeschler, J. et Auchlin, A., 2000:19). Nga studiues të tjerë ky dallim bëhet mes emërtimeve “*idiomë*”, që parakupton realitetin gjuhësor të folur a të shkruar, dhe *gjuhë*, që parakupton objektin hipotetik të ndërtuar në një teori, gjithnjë në pritje të një modifikimi” (Sériot, P., 2013:200).

<sup>5</sup> Duhet theksuar që nocioni i “disiplinës”, *shkencore a të zbatuar*, shfaqet në një moment të caktuar të zhvillimit të mendimit shkencor, ndërsa dija fillon e klasifikohet në varësi të ngjizjes së saj e kërkesave të mësimdhënies në institucione të arsimimit qysh nga mesjeta e këtej; por si dije shkencore apo e zbatuar, me të njëjtat cilësi përgjithësisht, por me emërtime të tjera, shfaqet qysh në hershmërinë e zhvillimit të

ishin tejet të lidhura me njëra-tjetrën (madje në fusha të caktuara ishte e vështirë të flisje për praninë e njëres a tjetrës, madje do të ishte i pamundur togu dije *teorike* a *praktike* si opozicion mes këtyre dy qasjeve).

Në fushën e shkencave të sakta (ekzakte), e sidomos në ato të lidhura me industrinë, ky dallim bëhet më lehtësisht i përcaktueshëm; por edhe aty pikëvështrimet nuk janë të njëjtësuar dhe studiuesit nuk bien në një mendje. Sillen argumente për të mbrojtur të ashtuquajturin “model linear”, sipas të cilit “studimi bazë, fundamental është i aftë të na drejtojë në shkencën e zbatuar, e cila çon nga ana e saj në zhvillimin industrial dhe, në një kuptim më të gjerë, në përfitim të produkteve”; ka, nga ana tjetër, argumente për një model tjetër, kundër këtij lineariteti, siç ka edhe qëndrime që parapëlqejnë një model jo-linear, pra as linear, as kundër-linear<sup>6</sup> (shih Llewelyn Smith, C.H., 2008). Por ka edhe qëndrime që mbeten përkrahëse të idesë se mund të flitet veçse për shkencë të mirëfilltë, teorike, veçse për një tip të dijës shkencore, dhe jo për shkenca të zbatuara.<sup>7</sup> Në këto kontekste, mbetet më pajtues pohimi se “shqyrtimi historik i sukseseve të studimeve shkencore moderne ka treguar në një mori rastesh që ndërveprimet mes njohurive bazike, teknologjisë dhe produkteve, edhe pse në nisje pa ndonjë lidhje, janë aq të forta saqë, edhe duke qenë të ndara e të dallueshme, ato janë të gjitha përbërëse të së njëjtës thurimë që i parakupton pranë njëra-tjetrës” (shih në Llewellyn Smith, C.H., 2008).

Në mënyrë të veçantë, e sidomos në periudhën e mbizotërimit të pozitivizmit, në shkencat e natyrës ky dallim krijoi edhe një lloj hierarkizimi të vlerave të punës së bërë, në lartësitë e së cilës vendoseshin dijet teorike e, më

mendimit shkencor. Ndaj e shtrijmë vështrimin për dijet teorike e të zbatuara herët, në antikitet, ku i kanë zanafillat disa prej tyre.

<sup>6</sup> Më 1916, J. J. Thomson-i, zbuluesi i elektronit, theksonte: “Me studim në shkencën e mirëfilltë, të pastër, unë parakuptoj kërkimin e bërë pa synimin e zbatimit në fushën industriale, me qëllimin e vetëm për ta shtrirë njohjen tonë drejt njohjes së ligjeve të natyrës.” Gjithsesi, sipas tij, edhe kjo mënyrë ka “dobinë” e saj. Ai sjell si shembull metodën e përdorimit të rrezeve X në mjekësi që “është rezultat i kërkimit në shkencën e pastër, që synonte të zbulonte natyrën e elektricitetit”. Sipas tij, “shkenca e zbatuar çon në reforma, shkenca e pastër në revolucione [...]”. Në një pikëvështrim të përkundërt me të kemi pohimin e George Porter-it, kimistit britanik, fitues i çmimit Nobel (1967), i cili theksonte se “termodinamika i detyrohet më shumë makinës me avull, sesa makina me avull i detyrohet shkencës” (cituar nga Llewelyn Smith, C.H., 2008).

<sup>7</sup> Si shembull merret qëndrimi i Louis Pasteur-it, i cili, megjithëse kërkimin shkencor e kishte tejet të lidhur me zbatimin shkencor, në një shkrim të botuar më 1868-ën theksonte: “Jo, një mijë herë, jo, nuk ekziston një kategori e shkencave të cilave mund t’u japim emrin e shkencave të zbatuara. Ka veçse një shkencë dhe zbatime të shkencës, të lidhura mes tyre si fruti me pemën që e prodhon atë” (cituar nga Carnino, G., 2014: 9-26).

tej, në shkallë më të ulëta, ato të natyrës zbatuese a teknike. Është një paragjykim miklues e motivues për studiuesit që u përkushtohen aspekteve teorike të disiplinave përkatëse, përkushtim që kërkon shumë mund, aftësi intelektuale, talent dhe dije të thella e të gjithanshme, por jo fort i motivuar në kohën e tanishme, kur teorizimet e zbatimet kanë krijuar të tjera lidhje, të tjera kushtëzime, madje marrëdhënie të tilla ku s'mund të vendoset qartazi një hierarki, ngaqë më shumë shfaqet reciprociteti a ndikimet e ndërsjellta përgjatë zhvillimit të dijes.

Edhe nga studiuesit e shkencave të ligjërimit vihen re vështirësitë që lindin në raportet që vendosen mes shkencës teorike e asaj të zbatuar. D. Maingueneau-ja thekson: “Tradicionalisht dallohen dy prirje në përfitim dhe ushtrimin e një dijeje shkencore: një prirje e parë që do të synojë përfitimin e një dijeje ‘të pastër’, ‘mirëfilli teorizuese dhe të paiteruar ndaj mjedisit rrethues’, dhe një prirje e dytë që do të synojë që dijet e përfutuara të jenë ‘të zbatuara’. Gjuhësia nuk bën dallim prej kësaj rregulle të përgjithshme: pranë gjuhësisë që synon të analizojë dhe të modelojë komunikimin verbal, ekziston një gjuhësi e zbatuar e cila sjell ndihmesën e saj në fusha nga më të ndryshmet të jetës shoqërore. Në fakt, është e vështirë përgjithësisht që të dallohen qartë kufijtë mes këtyre dy prirjeve të dijes shkencore, të cilat ndërveprojnë në mënyrë të vazhdueshme: kërkimi ‘i pastër’ është mjaft herë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, i drejtuar a matuar nga zbatimet e dijes shkencore, zbatime që shpeshherë mund të sjellin pasoja të paparashikuara; përveçse zbatimet e dijeve shkencore nxjerrin pa pushim probleme të reja para kërkimeve ‘të pastra’ shkencore” (Maingueneau, D., 2009:163).

Gjithsesi jo në çdo rast praktika e ka të mundur të dëshmojë drejtpërdrejt ligjësitë e zbuluara nga shkenca; veçanërisht kjo është më e dukshme në shkencat humane. Ndryshe nga shkencat e sakta, ku “[...]ligjet e zbuluara nga fizikanët kanë mundësuar që të dërgohen njerëzit në hënë”, ku “praktika tregon fare mirë që ligjet ekzistojnë në realitet”, ky pohim s'mund të bëhet ende për gjuhësinë dhe shkencat humane në përgjithësi” (Lazard, G., 2013:166).

- *Homo sapiens-i lind natyrshëm homo elokuens-in e homo faber-in*

Duke e hedhur vështrimin më nga afër në përvojat e grumbulluara në zbatimin e teorive gjuhësore, mund të pohojmë se idetë, teoritë a interpretimet që ngjizin e përvijojnë mendimin gjuhësor në një kohë a hapësirë të caktuar gjeografike, nxiten nga nevoja e njeriut për të zotëruar sa më mirë mjetin e tij të komunikimit, gjuhën; nga kërkesa e vijueshme për t'i ardhur në ndihmë atij në veprimtarinë e shumanshme sociale. Si i tillë, mendimi gjuhësor do të bartë njëherazi me dijen që përpunohet, dy aspekte që e bashkëshoqërojnë përgjatë të gjitha fazave të zhvillimit të tij: një grumbullim njohurish të cilat priren të

ndriçojnë më mirë natyrën e funksionin e njësave a dukurive gjuhësore që bëhen bartëse të formësimit sa më të përshtatshëm të ligjërimit; e po ashtu, edhe një sërë njohurish që nxiten nga faktorë të tjerë (më së shumti të natyrës sociale), që ndikojnë në përsosjen e komunikimit përmes njohjes e zotërimit të teknikave a procedurave që e mundësojnë atë përsosje. Në vijimësi këto dy aspekte të formësimit të njohurive, të kësaj dijeje të përftuar, bashkëjetojnë, duke marrë përparësi ndaj njëra-tjetrës në kohëra a situata të caktuara të zhvillimit të dijes. Në fakt, vetë kjo prirje e njeriut lind si pasojë e natyrës së qenies njerëzore si një *homo sapiens* (si qenia që arrin ta përftojë e bartë dijen), që zhvillon a gjeneron më tej, nga njëra anë, *homo loquens*-in (që arrin të ngjizë e shprehë gjuhësisht atë dije, që arrin të reflektojë ndaj botës) dhe, nga ana tjetër, *homo faber*-in (që është i aftë ta përmirësojë me veprimet e tij mjetin e tij të komunikimit). Sigurisht që këto veti të *homo sapiens*-it kanë mundësuar qasjen e tij të arsyeshme ndaj realitetit ku jeton, kanë karakterizuar vetë mendimin shkencor në tërësi, lindjen e dijes shkencore teorike, por edhe të zbatuar, të specifikuar në disiplina a kahje të caktuara, në varësi të fushës së veprimtarisë kërkimore, metodave, koncepteve specifike të përdorura në shqyrtim.

Nëse hedhim vështrimin në thellësi të kohërave, do të vërejmë që këto dy pamje janë karakterizuese të dijes qysh në ato fillime. Sipas qasjes aristoteliane, “nëse inteligjenca njerëzore apo aftësia për të njohur botën zëvendëson instinktin natyror të kafshëve të tjera, kjo inteligjencë ka dy funksione: të njohë gjërat dhe të zbatojë këto njohuri në drejtim të aktiviteteve njerëzore” (shih Sasseville, M., 1999: 307).

Vetë dija e përftuar shfaqet me dy pamje: “njëra spekulative, ndërsa ushtrohet vetëm për të përftuar njohuri, si qëllim në vetvete; tjetra praktike, ndërsa ushtrohet për të vepruar”<sup>8</sup> (Sasseville, M., 1999:288-289). Dhe më drejtpërdrejt akoma mund të shpreheshim përmes pohimit të Gérard Lenclud-it i cili thekson se “përtej larmisë së fjalëve që kanë shërbyer për ta emërtuar formalisht, vetë nocioni i shkencës së zbatuar është po aq i vjetër sa edhe ai i shkencës. Duhet vërejtur në fakt, që ideja moderne e shkencës, ajo që

<sup>8</sup> Sjelljet intelektuale (që ndryshe i quajmë shkencë), sipas M. Sasseville-it, “Aristoteli i vërente të lidhura, nga njëra anë, me inteligjencën apo aftësinë për të njohur, për të kuptuar dhe, nga ana tjetër, me inteligjencën a aftësinë praktike. *Inteligjenca spekulative* është quajtur gjithashtu *teorike* (prej greqishtes *theôrein*). Emërtimi *spekulative* vjen prej latinishtes që i korrespondon *specio*, që do të thotë *të shohësh, të vështrosh, të vëzhgosh*; ta zhbësh përgjatë të menduarit atë çka kërkon të njohësh, ta analizosh në elementet e saj; ndërsa *praktike* vjen prej greqishtes *prassô* që do të thotë *të përmbushësh, të realizosh*; pra të synosh veprimin, zbatimin e njohurive, të ngjizësh, të sintetizosh, pra të veprësh së jashtmi (Sasseville, M., shënimi 8 dhe 9, 1999: 287, 288, 289).



përvijohet në agim të revolucionit galileian, është ngjizur prej dallimit në konceptimin e vjetër të shkencës, që dallon teorinë prej praktikës, [...]funksionin e dijetarit prej atij të inxhinierit” (Lenclud, G., 2008:50).

Është domethënëse kjo përvojë e përftuar qysh në hershmëri, ndërsa synimi për të zhvilluar aftësitë ligjërimore vendosej në bazë të zhvillimit të dijes, jo vetëm teorike, spekulative, por edhe të arteve spekulative që ishin në bazë të zhvillimit të arteve liberale, që parakuptonin qysh në antikitetin e vonë dhe periudhën e mesjetës dije shkencore të një natyre të veçantë të cilat përbënin bazën për arsimimin e njeriut me kulturën e duhur.<sup>9</sup>

Përvijimi i dijeve dhe përvojave të arteve liberale në arsimimin e fëmijëve të familjeve antike parakuptonte këto fusha të dijes me natyrë zbatimi praktik: *gramatikën, retorikën dhe dialektikën*, që përbëjnë të ashtuquajturin *trivium* apo “artet e të folurit”, të konsideruara ndërkohë nga studiuesit e sotëm si ekuivalent i shkencave të komunikimit” (shih Pierre Levy, 1998: 48)<sup>10</sup>.

Natyra e shfaqjes së ligjërimit si një dukuri “heteroklite”, tejet e larmishme, ka mundësuar pra qasje të shumta në shqyrtim, interesim të vazhdueshëm nga disiplinat që formësonin dijen gjuhësore, por edhe disiplina të tjera. Mund të shpjegohet në këtë mënyrë prirja e vërejtur në mendimin gjuhësor qysh në hershmëri përmes teorizimit a përfthimit spekulativ të njohurive në lidhje me të, e po ashtu edhe përvijimi i njohurive të lidhura më drejtpërdrejt me gjuhën a gjuhët përmes gramatikës e më vonë gjuhësisë e gjuhësisë së zbatuar. Na e sjell të përgjithësuar përvojën e përftuar në këtë fushë pohimi i Oliver Soutet-së: “I përkufizueshëm më së pari në nivelin antropologjik, si aftësi e veçantë njerëzore, ligjërimiti analizohet si dukuri komplekse ku janë të pranishëm përbërës biologjikë, psikologjikë, sociologjikë,

---

<sup>9</sup> “Në antikitet, qysh me Aristotelin, dija shkencore e shfaqur si shkencë spekulative - shkencat natyrore dhe metafizika - bashkëshoqërohet nga dijet që, duke qenë gjithnjë shkenca, janë quajtur *arte spekulative*, sepse u ngjajnë arteve qoftë nga objekti i tyre – matematika - qoftë nga objekti e qëllimi i tyre – logjika” (M. Sasseville 1999:289). Por duhet theksuar se në dijen antike ndahet teoria prej *thechné-së*. [...] Lidhja e vërtetë mes teorisë dhe *thechné-së* është produkt i kuptimit modern mbi shkencën që zë fill me Galileun, Dekartin (Descartes) dhe Njutonin (shih Lenclud, G., 1995:37).

<sup>10</sup> Sipas P. Levy-t, “me termin ‘arte liberale’ në Mesjetë trajtoheshin disiplinat intelektuale bazike, njohja e të cilave ishte dukshëm e domosdoshme për përvetësimin e një kulture të lartë. Si dije për përfthimin e shprehive, *gramatika* parakuptonte në fakt zotërimin e latinishtes së shkruar e të folur; si shkencë, do të mund ta krahasonim me gjuhësinë bashkëkohore. *Dialektika* do të parakuptojë kompetencën argumentuese dhe logjikën. Ndërsa *retorika* interesohej për artin e të bindurit dhe ngjizjes së diskurseve. *Triviumi* parakupton në thelb shkencat e komunikimit. *Kuadriviumi* (Quadrivium) parakuptonte pjesët kryesore të ‘shkencave ekzakte’ të epokës, domethënë aritmetikën, gjeometrinë, muzikën dhe astronominë. Artet liberale përqaseshin a ishin në opozicion me artet mekanike: agrikultura, navigacioni, tekstilet etj. (Levy, P.,1998:48).

historikë dhe simbolikë. I përkufizueshëm më tej në nivelin e funksionimit të tij të brendshëm, si koncept unifikues që bashkon në vetvete varietetin e gjuhëve të veçanta, ligjërimi përshkruhet duke u nisur prej rregullave dhe tipareve të organizimit prej të cilave gjithçka mundëson të mendohet që ato mund të jenë veçse me një përgjithësim tejet të lartë, pra abstrakte” (O. Soutet, 2011:XVI).

Por në përvojën e tij të përditshme, njeriu përballet natyrshëm edhe me nevojën për të nxënë e zotëruar gjuhë të tjera, për të gjetur e siguruar një rrugë sa më të efektshme për ta bërë funksional mjetin e tij të komunikimit. E ndaj lindin përpjekjet e produktet e një fushe tjetër kërkimi që quhet sot “gjuhësi e zbatuar”, që do të parakuptonte, sipas Oliver Soutet-së “përpunimin e gramatikave të veçanta për gjuhët e ndryshme, të trajtuara si gjuhë të huaja (dhe jo si gjuhë amtare), rregullimin a rishikimin e gramatikave krahasuese të dy ose shumë gjuhëve që mundësojnë të paraqiten mënyrat e transpozimit të strukturave gramatikore të njëres në strukturat gramatikore të tjetres (ose të të tjerave)”, e më vonë, “fabrikimin e makinave të përkthimit në kuadër të një programi të quajtur përkthim automatik [...]. Kuptohet tashmë dimensionin praktik i këtyre instrumenteve nuk duhet të zbehë faktin që ato parakuptojnë konceptualisht zotërimin shkencor të larmisë së gjuhëve. Gjithsesi [...] ato nuk e parakuptojnë këtë të përdoruesi i tyre – tamam si drejtimi i automjetit nuk parakupton zotërimin intelektual të asaj çka është funksionimi i një motori të shoferi a drejtuesi i automjetit” (Soutet, O. 2011:4-5).

Bëhet e motivuar, në këtë mënyrë, tradita e përvijuar në zbatimin e dijeve gjuhësore; e më tej objekti i gjuhësisë së zbatuar - “shqyrtimi teorik dhe empirik i problemeve të jetës reale në të cilën gjuha është çështje qendrore” (Bramfit, Ch., 1997:93).

• *Tradita e përvijuar në zbatimin e dijeve gjuhësore para institucionalizimit të gjuhësisë së zbatuar*

Mund të mendohet në mënyrë thjeshtëzuese se vëzhgimi i veçantive të njësive të sistemit gjuhësor dhe dukurive të ndryshme të lidhura me to, ka nxitur, qysh nga antikiteti, teorizimet në lidhje me gjuhën e ligjërimin dhe zbatimin e dijeve të përftuara për nevoja të ndryshme sociale.

Për evoluimin e mendimit gjuhësor në shekuj, qysh nga fillimet e tij deri në shekullin XX, kur gjuhësia shfaqet me tiparet e një shkence të konsoliduar e moderne, studiuesit i referohen rëndom përcaktimit përgjithësues të E. Benveniste-it, i cili periudhën nga fillimet deri në shekullin XX e sheh si periudhë të teorizimit e të krahasimit dhe jo të vëzhgimit e shqyrtimit të gjendjes së brendshme të gjuhës. E. Benveniste-i thekson: “Dihet tashmë që gjuhësia perëndimore lind përmes filozofisë greke. [...] Por interesi që mendimtarët grekë kishin qysh në fillim për ligjërimin ishte mirëfilli filozofik. [...] Përgjatë shekujsh, qysh prej Parasokratikëve deri te Stoicienët dhe

Aleksandrinët, pastaj përgjatë rilindjes aristoteliane që vijon të menduarit grek deri në fund të Mesjetës latine, gjuha ka mbetur objekt i spekulimit (teorizimit) dhe jo i vëzhgimit. [...] Ky qëndrim nuk ka ndryshuar aspak deri në shekullin XVIII. Një fazë e re hapet në fillim të shekullit XIX me zbulimin e sanskritishtes. [...] Gjuhësia zhvillohet përmes pikëvështrimeve të gramatikës krahasuese, me metoda që bëhen gjithnjë e më të përpikëta [...]. (Benveniste, É., 1966:19).

Kjo qasje ndaj gjuhës, kjo veçanti e zhvillimit të mendimit gjuhësor, e cila kushtëzohet nga mjedisi social, politik, ideologjik i shoqërive ku zhvillohet mendimi filozofik e gjuhësor, nxitej e u shërbente kryesisht interesimeve që lindnin jashtë fushës së gjuhësisë, interesimeve të nxitura sidomos nga filozofia, por edhe feja, e drejta, mësimdhënia e nxënia e gjuhë-s/-ve, politika. Pikërisht kjo nxitje së jashtëmi mundësonte, kërkonte, parakuptonte edhe qasjet zbatuese a zbatimin e njohurive gjuhësore, sepse gjuhës a ligjëritit i vlerësohej roli i rëndësishëm në veprimtarinë sociale, ndikimi në zhvillimin e shoqërisë (shih edhe R.H. Robins, R.H., 1976).

Nuk ishte e rastit që nevoja për përfitim të teknikave të të bindurit lindi ndërsa zhvillimet politike në qytetërimin e vjetër grek po nxitnin prirjet për demokracinë në atë qytetërim; siç thekson D. Maingueneau, “përvijimi i demokracisë greke (fundi i shekullit VI p.e.s.) mundësoi të kalojë në plan të parë shqetësimi për të zotëruar burimet e kompetencave të argumentimit juridik ose politik, çka nxiti shfaqjen e profesionistëve, teknikienëve të të folurit, sofistëve (shekulli V p.e.s.). Mjeshtrit e retorikës, që dëshironin t’u jepnin nxënësve [...] mjetet për t’u imponuar përmes të folurit, e kanë konsideruar ligjërimin si një instrument përmes të cilit duhej të analizoheshin burimet për t’i përdorur në dobi të tyre (Maingueneau, D., 2009:10). Po ashtu, përpjekjet e gramatikanëve indianë, qysh në shekullin XII p.e.s. e deri në dëshminë konkrete që vjen me *Tetë librat* e Paninit (shekulli IV p.e.s.) janë të nxitura jo aq prej nevojave për shqyrtimet e brendshme gjuhësore, sesa prej nevojave të nxitura nga feja, që përshkrimin e hollësishëm të sanskritishtes e nxiste për të arritur efektshmërinë sa më të madhe të ceremonive fetare përmes shqiptimit sa më të saktë e interpretimit sa më të mirë të teksteve të shenjta.

Gjithashtu, synimet në radhë të parë didaktike, pedagogjike e kulturore nxitën hartimin e gramatikave në periudhën antike e më tej në mesjetë. Kontribute të natyrës praktike, të lidhura me njohuritë gjuhësore e letrare solli veprimtaria shqyrtuese e interpretuese e dijetarëve të Shkollës së Aleksandrisë (në shekullin III p.e.s.) me studimet në fushën letrare e gjuhësore, një lloj shqyrtimi i kujdesshëm filologjik i teksteve më të hershme (për shembull, Homeri), për t’i kuptuar më mirë ato, studime që janë konsideruar edhe si pararendëse të gramatikës shkollore tradicionale që ka për objekt studimi veprat letrare më në zë (shih Maingueneau, D., 2009:11; Mebiame-Akono, P., 2009:29-30).

Por mund ta zgjerojmë kufirin e përkujdesjeve për anën praktike të shqyrtimeve në lidhje me gjuhën edhe më gjerë e më herët, në shekullin XII p.e.s. në qytetërimin e hershëm kinez, me përkujdesjen për kaligrafinë për shkak të morisë së karaktereve të përdorura për shkrimin (“fonologët e parë kanë qenë pikërisht ata që kanë fabrikuar shkrimet alfabetike”, do të thonim përmes G. Mounin-it (cituar nga François, F., 2013:140)). Mund të theksojmë po ashtu përkujdesjen për diskursin në antikitetin romak, në vijim të shqyrtimeve të shkollës së Aleksandrisë (për shembull përpjekjet e Quintilian-it – shekulli I e.s. – në kuadër të retorikës, për një formë sa më shprehëse të të folurit); le të përmendim po ashtu punimet e arabëve (shekulli VIII e.s.) në fushën e leksikografisë ; prurjet e studiuesve hebrenj në shekullin X dhe XI përmes prirjes krahasuese në analizat e hebraishtes dhe arabishtes, që mundësuan më tej familjarizimin e gramatikanëve europianë me traditën gjuhësore të popujve semitikë.

Në një periudhë të mëvonshme, ishin nxitjet e natyrës politike, prirja për forcimin e pushtetit të centralizuar që çoi në shekullin XVI në kërkesat për kodifikimin e gjuhës, dhe kjo kërkesë çoi në hartimin e gramatikave, njohuritë e të cilave do të zbatoheshin e përdroreshin në funksion të atij kodifikimi. Për të ardhur në kohët më të reja, me shtysat kulturore e metodologjike të komparativistëve dhe gramatikave të krahasuara dhe nevojën e punën për grumbullimin e të dhënave dhe përshtatjen e zbatimit e njohurive teorike në përzgjedhjen e tyre.

Lindja e gjuhësisë si shkencë në shekullin XIX ishte pasojë e një përballjeje të frytshme mes gramatikave krahasuese të gjuhëve indoeuropiane dhe përpjekjeve për të arritur në përgjithësime prej fakteve të grumbulluara ndërkohë përmes të dhënave nga gjuhë të shumta, një tjetër aspekt i kahjes së zbatuar.

Le të kujtojmë që pothuaj në të njëjtën epokë kemi, nga njëra anë, prurjet shkencore të Wilhelm von Humbold-it (duke filluar nga 1820-ta, i cili synon të përvijojë një teori të përgjithshme gjuhësore, duke u mbështetur në të përbashkëtat e veçantitë e gramatikave të gjuhëve të Europës, Azisë etj., duke shënuar me prurjet e tij lindjen e gjuhësisë së përgjithshme); e nga ana tjetër, botimin e katër vëllimeve të njëpasnjëshme të “Mitridatit” (Mithridates) i Johann Christoph Adelung-ut e Johan Severin Vater-it që ka të pranishme e të organizuara gjeografikisht përkthimet e “Pater Noster-it” (Ati ynë) në pothuaj 500 gjuhë të të gjithë planetit (shih më gjerë në [nej.francois@interlingua.fr](mailto:nej.francois@interlingua.fr)); një përpjekje që nxirrte në pah veprimin e njeriut mbi gjuhën, aftësinë ligjërimore, krahasimin, kontekstualizimin e ngjizjen gjuhësore: jo një përgjithësim, por një përqsasje, një krahasim, përkthim, një punë në fushën e traditës zbatuese të njohurive, sepse synoi mbledhjen e të dhënave përmes përkthimit nga gjuhët

“vernakulare”, domethënë të përdorimit të përditshëm, që pasqyronin realitetin ligjërimor të kohës në gjuhët përkatëse.<sup>11</sup>

Duhet të theksojmë gjithashtu se produkte të këtij zbatimi që krijuan traditë janë edhe ato në fusha shumë më larg gjuhësisë, por që lidhen me gjuhët e ligjërimit, si në fushën e mjekësisë, më ngushtë në atë të ortofonisë, logopedisë ose riedukimit të të folurit, të shqiptimit të drejtë të fjalëve e deri te mjekimi i patologjive të ndryshme të të folurit; për të ardhur në shekullin XX, ku në mënyrë intensive u përvijuan produkte që ndihmojnë njeriun në veprimtaritë e tij sociale të lidhura me gjuhën përmes të ashtuquajturës “informatikë gjuhësore”, apo “industri e gjuhës”, në fusha të tilla studimi e zbatimi, si përkthimi automatik, mësimdhënia e asistuar nga ordinatori, dialogu njeri-makinë, hartimi i teksteve përmes Inteligjencës Artificiale, teknikave të sintezës zanore etj. (shih më gjerë Maingueneau, D., 2009:165-172). Përvijimi i kësaj tradite të zbatimit të njohurive teorike gjuhësore ka synuar jo thjesht lehtësimin e përpjekjeve të njeriut për ta “zotëruar” gjuhën, por edhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme sociale që shkaktohen si pasojë e pengesave gjuhësore në komunikim në brendësi të institucioneve (në shkollë, administratë, mjediset e punës etj.) apo në nivele politike, ideologjike etj. (D. Maingueneau, 2009: 172-174).

Studimi i traditës së përvijuar historikisht në zbatimin e njohurive gjuhësore në fusha të ndryshme të veprimtarisë sociale nxjerr në pah, pra, njohuri që janë formësuar si dije të zbatuara edhe para institucionalizimit të gjuhësisë së zbatuar si disiplinë autonome në shkencat e ligjërimit. Janë disiplina të ndryshme shkencore, me një objekt të përcaktuar që lidhet me gjuhën a ligjërimit, me metoda po ashtu të përcaktuara që shqyrtojnë dukuritë e ndryshme nga fusha të ndryshme të veprimtarisë sociale, si mësimdhënia e nxënia e gjuhëve, hartimi i fjalorëve, studimi statistikor i leksikut, çrregullimet e të folurit etj., që kishin përfutur disiplina të tilla, si didaktika e gjuhëve, leksikografia dhe statistika leksikore, përkthimi a traduktologjia, logopedia etj. etj., disiplina që do të bëheshin pjesë e natyrshme e metadisiplinës Gjuhësi e Zbatuar në gjysmën e dytë të shekullit XX.

---

<sup>11</sup> Le të kujtojmë një përpjekje paralele në traditën e mendimit tonë gjuhësor me përkthimet e *Biblës*, në variante dialektore të saj në shqip, veçanërisht punën e K. Kristoforidhit me përkthimin e botimit e pjesëve të ndryshme nga *Dhjata e Vjetër* dhe *Dhjata e Re* në gegërisht e toskërisht, apo angazhimin e Luigj-Lysjën Bonapartit për studimin e disiplinimin e të dhënave dialektore nëpërmjet hartimit të hartave dialektore për pothuaj 55 ngulime arbëreshe ku shqipja flitej në gjysmën e dytë të shekullit XIX apo për përkthimin e botimit e fragmenteve të ndryshme prej teksteve biblike në variante të të folmeve të shqipes, si tri variantet e *Ungjillit sipas Mateut* dhe *Parabolës së Farëdhësit*, apo 14 variantet e *Lutja ndaj Zotit (Ati ynë/Pater noster)* në të folmet e ndryshme të arbërishtes, por edhe në toskërisht, në të folmen e Shqipërisë së Mesme ose në shkodranisht (shih Përnaska, R., Plangarica, T., 2020:303-314).

• *Mbi disa kritere të përfshirjes së dijeve në gjuhësinë e zbatuar*

Duke e dalluar zbatimin e njohurive gjuhësore si praktikë të përhershme në studimet gjuhësore nga disiplinat e formësuara në kuadër të gjuhësisë së zbatuar dhe duke qenë se fusha e studimit të gjuhësisë së zbatuar shfaqet si një fushë shumëdisiplinore, madje ndërdisiplinore e tejdisiplinore (apo si një (meta-)disiplinë me një sërë (nën-)disiplinash në përbërje të saj), studiuesit përpiqen të përcaktojnë kritere për të përcaktuar një dije disiplinore si dije të zbatuar në shkencat e ligjërimit a pjesë të gjuhësisë së zbatuar. D. Maingueneau-ja përcakton tri kritere: 1. *Disiplina e zbatuar i përgjigjet një kërkesë sociale* (Maingueneau-ja ka parasysh nëndisiplina të gjuhësisë së zbatuar, të tilla si didaktika e gjuhëve, përkthimi automatik, hartimi i fjalorëve, patologjitë e të folurit, etj., të cilat lidhen dhe u përgjigjen kërkesave të lidhura me nevojat e ndryshme të sektorëve po ashtu të ndryshëm të shoqërisë; 2. *Disiplina e zbatuar mbështetet dhe përdor njohuri dhe dije nga fusha të ndryshme të dijeve teorike* (Maingueneau-ja ka parasysh në këtë rast disiplina të tilla të zbatuara, si ortofonia a riedukimi i të folurit, që ka nevojë për dijet e gjuhësisë (veçanërisht të fonetikës eksperimentale), por edhe të neurologjisë, anatomisë, psikologjisë etj.; didaktika e gjuhëve, e cila ka nevojë e përdor dije jo vetëm të gjuhësisë por edhe të psikologjisë, të sociologjisë etj.; përkthimi automatik, që ka nevojë e përdor dije të gjuhësisë (madje të fushave të ndryshme të saj, si semantika, leksikografia, analiza e tekstit etj.), por edhe të informatikës; 3. *Disiplina e zbatuar vlerësohet prej rezultateve të saj* (Maingueneau-ja ka parasysh produktin e përfutur si pasojë e zbatimit të njohurive teorike të përfutura në nëndisiplina të ndryshme përkthuese të gjuhësisë, produkt që u shërben zgjidhjeve të problemeve të parashtruara nga nevojat sociale, për shembull, të mësimdhënies a nxënies së gjuhë-s/-ve, të terminologjisë në fusha të ndryshme të veprimtarisë së njeriut etj. (shih më gjërë Maingueneau, D., 2009:163-165).

Duke patur parasysh këto kritere mund të vërehet pa vështirësi që praktika e zbatimit të dijeve të përfutura në fushën e gjuhësisë është e pranishme edhe para institucionalizimit të vonë të kësaj fushe kërkimi, por po ashtu i pranishëm është edhe përvijimi i disiplinave që do të integrohen natyrshëm në një kohë më të vonë në gjuhësinë e zbatuar. Është kjo traditë e përvijuar periudhë pas periudhe, është kjo vëmendje e vijueshme e përvojave studimore të gjuhës e ligjërimit ndaj aspekteve të zbatuara të njohurive gjuhësore që e bën të motivuar pohimin analogjik që “gjuhëtari bën gjuhësi të zbatuar pa e ditur këtë gjë” (pohim i V. Bahner-it, cituar nga Slama-Cazacu, T., 1984:12).

• *Mbi evoluimin e domethënies që shenjon emërtimi gjuhësi*

Ndërsa flasim e vijojmë të përdorim gjithnjë emërtimin e disiplinës a fushës së studimit “gjuhësi e zbatuar”, natyrshëm mund të lindin mëdyshje kur e drejtojmë vëmendjen te përbërësi i parë i emërtimit, “gjuhësia”. Siç theksuam më parë, vetë gjuhësia është një shkencë e re; siç dihet, në formën moderne të shfaqjes së saj, ajo është produkt i shekullit XX, sidomos me kontributet e Sosyrit dhe ithtarëve të tij strukturalistë, që sollën rezultate të spikatura në studimin e strukturës e sistemit gjuhësor (më saktë sistemeve gjuhësore), duke u formësuar si shkencë teorike, fundamentale, “e pastër” a “e mirëfilltë”.

Natyra e dijeve të përfuara në kuadër të kësaj gjuhësie duket se e bën disi të papërputhshme pranëvënien e dy përbërësve në emërtimin “gjuhësi” dhe “e zbatuar”: nga njëra anë “gjuhësi” (çka do të parakuptojë, sipas “Kursit...” të Sosyrit, jo shqyrtimin në tërësi të dukurive ligjërimore, por të një objekti unitar, të thjeshtë, të vetëm, që e quajmë *gjuhë*, duke lënë mënjanë me vetëdije gjithçka që lidhet me diskursin, të folurin dhe gjithçka që përlind përftohet prej tyre, por edhe çdo bazë a mbështetje neuropsikologjike të veprimtarisë ligjërimore dhe çdo kushtëzim social, historinë e gjuhës dhe ndryshimeve të saj apo edhe ndryshimin e saj hapësinor”) (Lazard, G., 2013:60); dhe nga ana tjetër “e zbatuar” (pra në funksion të nevojave sociale për arritjen e një komunikimi sa më të efektshëm në përditshmërinë e përdorimit të tij nga individit a komuniteti gjuhësor, në mësimdhënie a nxënien e gjuhë-s/ve etj.). Ndaj qysh në fillimet e institucionalizimit të gjuhësisë së zbatuar, qysh në numrin e parë të revistës së *Shoqatës Franceze të Gjuhësisë së Zbatuar*, “Bulletin de l’Afla” studiuesit nxitojnë të theksojnë: “Mbiemri ‘i zbatuar’ i bashkëngjitur me emrin ‘gjuhësi’ në emërtimin ‘gjuhësi e zbatuar’, tregon atë çka është objekti i kërkimit, që nuk është gjuhësia si studim i funksionimit të gjuhës, por gjuhësia e lidhur në mënyrë të pazgjydhshme me përmbushjen e një numri tjetër detyrash, të ndryshme nga studimi i funksionimit të gjuhës, detyra që s’mund të përmbushen gjithsesi në mënyrë të pavarur prej gjuhësisë” (Bulletin de l’Afla, 1978:1).

Pra emërtimi lindi si tog pikërisht për të bërë diferencën mes dijes teorike, “të pastër” gjuhësore ndaj dijes (gjuhësore) “të zbatuar” (edhe pse në hapësirat e saj kemi të pranishme edhe teorizimet përmes një qasjeje tjetër).

Gjithsesi duhet të mbajmë parasysh, gjithashtu, se jo gjithnjë emërtimet mbeten të përshtatshme për format “pagëzuese”, të cilat shprehin në ato çaste një domethënie të caktuar dhe më tej mbeten si “etiketa” që mbushen me domethënie jo aq nga ajo ç’del prej vetë njësisë a njësive në emërtim, sesa nga

domethëniet e zhvillimeve në vijimësi të vetë disiplinës a fushës së studimit, duke u rikuptimësuar me domethënie të re përgjatë zhvillimit të dijes.<sup>12</sup>

Bëhet më i qartë ky dallim, motivohen më shumë këto qasje nëse do të mbajmë parasysh zhvillimet e mendimit gjuhësor në shekullin XX të cilat janë intensive, në kahe të ndryshme metodologjike ndaj profileve të ndryshme të lëndës gjuhësore, që mundësuan objekte njohjeje në kuadër të gjuhësisë së gjuhës, por edhe të funksionimit, ngjizjes e përdorimit të saj në procesin e komunikimit, pra të gjuhësisë së ligjërimit, çka më së shumti do të përafroheshin, ndihmonin e nxitnin në një marrëdhënie shumëdisiplinore e ndërdisiplinore gjuhësinë *si të zbatuar a gjuhësinë e zbatuar*. Në këtë pikëvështrim, “qasjet që marrin parasysh dukuritë ligjërimore në situatën reale të përdorimit, në lidhje me nevojat e veçanta në komunikim, përbëjnë një vend vëzhgimi po aq interesant dhe legjitim sa dhe ato që kanë të bëjnë me gjuhësinë “teorike” (Condamines, A., et al. 2015).

Mbetet i motivuar në kontekstet e reja të zhvillimit të gjuhësisë së zbatuar mendimi me prirje disi më përgjithësuese i studiuesve, të cilët këtë fushë studimi duan ta shohin më shumë si një fushë të diferencuar prej disiplinave që e shohin objektin e tyre si një objekt teorik, të brendshëm në gjuhë (fonetika, semantika etj.), të dalluar prej disiplinave që përvijohen nga raporti me një element të jashtëm, nga raporti me praktikat sociale të jashtme (që mund të jenë natyrore – përvetësimi i gjuhës – ose institucionale – përsosja e kompetencës gjuhësore përmes shkollimit). Sipas kësaj qasjeje, me këtë problematikë angazhohen disiplina të ndryshme të shkencave të ligjërimit, disa prej të cilave përshkruajnë apo prirjen të kuptojnë se ç’ndodh në këto praktika të natyrshme ligjërimore e sociale, dhe disiplina të tjera, të cilat nxjerrin më në pah aspektin prakseologjik (të veprimit njerëzor), pra jo vetëm për të përshkruar, por sidomos për të bërë që situata të evoluojë (shih Bouchard, R., 1998: 327).

Kemi pra përgjatë këtij shekulli lulëzimin e njohurive të gjuhësisë “së pastër” e po ashtu, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX, të atyre njohurive gjuhësore që u prirën drejt ligjërimit dhe shkencave të ligjërimit. Përvijohet në këtë mënyrë një kontekst epistemologjik që duhet parë më për nga afër për të shpjeguar e motivuar institucionalizimin e gjuhësisë së zbatuar në gjysmën e dytë të këtij shekulli. Janë veçantitë e disiplinave teorike të kësaj

<sup>12</sup> Na duket e gjetur analogjia që bën M. Stegu në këtë rast: “[...] nuk do të duhej të ishim shumë kritikë në lidhje me “emrat/emërtimet” e disiplinave shkencore, të cilat shfaqen si shumë prej emrave/emërtimeve të tjer-ë/-a – emra/emërtime markash, ndërmarrjesh – që kanë gjithnjë prirjen të humbin më së paku një pjesë të domethënies së tyre zanafillore. Edhe pse një model i “Volkswagen-it” është tashmë mjaft i shtrenjtë dhe nuk përfaqëson më “një automjet për popullin”, nuk do ta ndryshonim gjithsesi emrin e mirëngulitur tashmë” (Stegu, M., 2011:132-133).



“gjuhësie kontekstualiste, të jashtme” që parakuptonin e nxitnin, motivonin e ushqenin studimet e kërkimet në fushën e gjuhësisë së zbatuar.

Parimet mbi të cilat u mbështet zhvillimi i gjuhësisë moderne të shekullit XX, me përvijimin e një modeli “imanentist”, strukturalist në qasje e studim, ku u dallua gjuha nga të folurit, dhe përqendrimi në fazën e parë të “gjuha si dukuri sociale”, si “kod i përbashkët për të gjithë anëtarët e një komuniteti gjuhësor”, si një “sistem shenjash që përbën një të tërë koherente”, një “sistem në të cilin çdo element është përcaktuar nga bashkësia e lidhjeve me elementet e tjera”, qenë të suksesshme, por të pamjaftueshme. Studimi i gjuhës si “sistem shenjash në plan sinkronik”, mundësoi lindjen e një dijeje teorike, shpesh e quajtur edhe “gjuhësi e gjuhës”, “gjuhësi e pastër”, që e rrezatoi këtë mënyrë të konceptimit të objektit të studimit dhe ndikoi madje, për një kohë të caktuar, edhe në qasjet metodologjike të shkencave të tjera humane e sociale. Gjithsesi, me gjithë sukseset e spikatuara të gjuhësisë strukturaliste për njohjen e shqyrtimin e sistemit gjuhësor, nënsistemeve, njësisive gjuhësore e veçantive që ato shfaqnin në gjuhë të ndryshme, kjo gjuhësi nuk arrinte të studioje e vetme ligjërimin. Pranohet gjithnjë e më shumë se “gjuhësia e pastër që kufizohet ngushtësisht në analizën e sistemit gjuhësor, ose më saktësisht të sistemeve të gjuhëve dhe në krahasimin e tyre, është veçse njëra prej shkencave të ligjërimin; ndërkohë ajo nuk përjashton asnjë prej të tjerave, në veçanti fushën e gjerë të studimit të diskursit (të të folurit), domethënë të ligjërimin në veprim. Përkundrazi, duke u vendosur në zemër të fushës së shkencave të ligjërimin, gjuhësia e pastër, e praktikuar në mënyrë rigorozë, u jep të ngjashmeve të saj një mbështetje të qëndrueshme që veçse i ndihmon e i përforcon ato” (G. Lazard, G., 2013:64).

Shfaqet më e qartë kjo pamje e zhvillimit të dijeve teorike e praktike në fushën e gjuhësisë, nëse do ta interpretojmë raportin e studiuesit me lëndën gjuhësore si një “dialogim” (nëse do të shpreheshim me termin e M. Bakhtin-it). Nga ky pikëvështrim, theksohet nga studiuesit, “objekti i gjuhësisë ndërtohet në funksion të origjinës së dialogut. Në rastin e gjuhësisë së quajtur teorike, çështja për shqyrtim, kërkesa për lind në vetë hapësirën e gjuhësisë; në këtë rast, objekti është i përvijuar nga një problematikë e formuluar me terma gjuhësorë (anafora, polisemia, emërimi...) dhe studiuesi mbështetet më së shumti në vetë korpusin e tij të folësit/dëgjuesit për të formuluar një hipotezë të funksionimit. [...]Në rastin e gjuhësisë të quajtur e zbatuar, çështjet në shqyrtim a kërkesa krijohen vetvetishëm prej një të treti, i cili shpesh nuk e formulon atë gjithësi me terma të gjuhësisë, por më së shumti me terma të vështirësive ose nevojave që lidhen me dukuritë ligjërimore (përmirësimi i të mësuarit të gjuhëve, përmirësimi i transmetimit të informacionit, përmirësimi i trajtimeve për të sëmurët afazikë...). Në këto raste, gjuhëtari duhet “të përcaktojë” kërkesën në terma gjuhësorë, çka i mundëson atij të përgjigjet si gjuhëtar, duke përdorur studimet që e kanë trajtuar tashmë në aspekte të caktuara këtë çështje a kërkesë

dhe duke përdorur një refleksion të tipit gjuhësor; në fakt, të përfshijë përpjekjen e tij në paradigmen gjuhësore” (Condamines, A., Nancy-Combes, J-P., 2015:8).

Në fakt, ka evoluar domethënia, objekti i studimit, qasja në studim e gjuhësisë. Në momentin e tanishëm gjuhëtari e ka zgjeruar tashmë misionin e tij, ka një tjetër përzgjedhje në “ndërtimin” e objektit të tij të njohjes. Sipas Moeschler-it e Auchlin-it, “vizioni klasik i studimit të ligjërimit parakuptonte që gjuhëtari të kishte për objekt të përshkrimit gjuhët natyrore, në hapësirë e në kohë. [...] Gjuhësia e sotme (parakupto shkencën e ligjërimit) ka përvijuar në fakt një objekt më abstrakt, por të një rëndësie më të përgjithshme, për të cilin njohja do të duhej të mundësonte të dinim se në çfarë konsistojnë gjuhët natyrore. Në mënyrë të përmbledhur do të thonim që **gjuhëtari nuk përshkruan gjuhët, por njohuritë që subjektet kanë për gjuhët** (nënvizimi i autorëve, TP) (Moeschler, J. et Auchlin, A., 2000:11).

Shfaqet pra një koncept tjetër epistemologjik dhe një kontekst marrëdhëniesh e kushtëzimesh të disiplinave gjuhësore ku ato teorike dhe zbatuese (a të zbatuara) nxisin e ndihmojnë njëra-tjetrën, ndërsjelltas. Madje roli i dijeve të zbatuara, i teknologjive e disiplinave të zhvilluara në kuadër të këtyre teknologjive (veçanërisht ai i informatikës) në shumë aspekte bëhet më parësor. “Kjo disiplinë (informatika, TP), vëren G. Lazard-i, e lindur më së voni, i ofronte inxhinierëve dhe studiuesve mjetet e reja me një fuqi të pavërejtur më parë, që i bënte ata të ëndërronin. Ata krijojnë bindjen se mund të zotërojnë strukturat e gjuhëve. Gjuhësia gjenerative që lindi në *Massachusetts Institute of Technology*, me publikimin e “Strukturave sintaksore” të Chomsky-it (1957) paraqitet në këtë pikëvështrim si shkencë e parë e vërtetë e gjuhëve për të cilën ky gjuhëtar ishte Galileu” (Lazard, G., 2013:50).

Duke analizuar zhvillimet në gjysmën e dytë të shekullit XX e në këta dhjetëvjeçarë të parë të shekullit XXI, vërehen marrëdhënie të reja ndërdisiplinore në një hapësirë të re të përfutur përmes shkencave të ligjërimit. Sylvain Aroux-ja pohon: “Në tridhjetë vjetët e fundit (pohimi bëhet në 2011-ën, TP), evolucioni i gjuhësisë vërehet dukshëm në tri aspekte: 1. Zhvillimi i paparë i njohurive historike mbi këtë disiplinë dhe paraqitjen e ligjërimit qysh prej Antikitetit më të hershëm; 2. Suksesi në rritje i matematizimit të disiplinës, mbështetur në zhvillimin e informatikës; 3. Një zbehje e identitetit dhe e unitetit/njësimiit disiplinor; sot flitet më shumë për “shkencë të ligjërimit” sesa për gjuhësi. Ky lloj evoluimi është domethënës, tregon kompleksitetin e fushës dhe nuk është domosdoshmërisht negativ. Ndërsa flasim për “matematikën” në shumës, kjo nuk ngjall asnjë dyshim për karakterin serioz dhe shkencor të tyre” (Aroux, A., 2013:11).

Nëse rezultatet e sukseset e gjuhësisë së gjuhës s’mund të kishin përgjithësisht ndikim të drejtpërdrejtë për nxitjen e fushave të ndryshme të

gjuhësisë së zbatuar dhe s'mund të nxisnin kërkesat për institucionalizimin e saj (ndërkohë që disiplinat që kishin krijuar traditë apo që krijonin përvoja të reja studimore si zbatim i dijeve gjuhësore - mësimdhënia e nxënia e gjuhëve (didaktika), leksikografia statistikore etj. - vijonin të zhvilloheshin pavarësisht modelit të ri metodologjik në gjuhësinë teorike), zhvillimi, intensifikimi i përpjekjeve dhe suksemi i disiplinave të ligjërimit më vonë krijoi kontekstin nxitës epistemologjik për institucionalizimin e dijeve në gjuhësinë e zbatuar.<sup>13</sup>

Me zhvillimet e reja u mundësua që të përvijohesh natyrshëm edhe një grup i dytë studiuesish, krahas atyre që interesoheshin për përshkrimin e gjuhëve, “që u interesuan në mënyrë të veçantë për studimin e aspekteve të ndryshme të përvijimit të gjuhës në diskurs a përgjatë të folurit në fusha të tilla, si: pragmatika, analiza e diskursit, informacioni dhe komunikimi, ndërtimi i kuptimit, ndërveprimi, përvetësimi i ligjërimit, didaktika etj.” (Lazard, G., 2013:53).

Për më tepër, gjuhësia tashmë kishte fatin “jo të mirë” të mos ishte e vetme në studimin e gjuhës a ligjërimit natyror, por tani “psikologjia, filozofia, informatika, inteligjenca artificiale, neuroshkencat etj., të gjitha kanë zhvilluar hipoteza dhe teori mbi ligjërimin, kanë prurjet e tyre për nxënien, përvetësimin, për domethënien, për referencën, për trajtimin e të folurit, për dialogun njerimakinë, për përkthimin automatik apo edhe për komunikimin patologjik. Situata e monopolit së cilës i gëzohej gjuhësia në lidhje me trajtimin e kësaj problematike ka tridhjetë vjet që është zhdukur (pohimi bëhet në vitin 1997, TP). Kjo shpjegon që aktualisht flitet me dëshirë më shumë për shkencat e ligjërimit sesa për gjuhësi” (Moescler, J. et Auchlin, A., 2000:6).

• *Konteksti më i drejtpërdrejtë epistemologjik në të cilin u institucionalizua gjuhësia e zbatuar*

Në shkencat e ligjërimit përfshihen një sërë disiplinash a një sërë fushash studimi (që gjenden të grupuara në mënyra të ndryshme në varësi të qasjes metodologjike të studiuesve), që ishin në çdo rast në bashkëmarrëdhënie më të ngushtë me vetë kahet e studimit a nëndisiplinat e gjuhësisë së zbatuar.

---

<sup>13</sup> Le të kujtojmë, gjithsesi, se edhe në klimën mbizotëruese “imanentiste” të viteve 1920, Eduard Sapir-i në Kongresin e Parë Ndërkombëtar të Gjuhëtarëve (Hagë, 1928) iu drejtua atyre duke theksuar se “mbetet të shpresojmë që gjuhëtarët do të ndërjegjësohen gjithnjë e më shumë për rolin e tyre për shkencën në përgjithësi dhe që ata nuk do të mbyllen në traditën që kërcënohet prej pedantizmit nëse ajo nuk gjallërohet nga interesimet që e tejkalojnë aspektin mirëfilli teknik të studimit gjuhësor. [...] Me dashje pa dashje, ata duhet të tregojnë një përkujdesje në rritje për problemet e shumta etnologjike, sociologjike dhe psikologjike që janë të pranishme në fushën e ligjërimit” (cituar nga Mebiame-Akono, P., 2009: 135).

Në këtë kontekst, falë ndërveprimit të dijeve mes gjuhësisë, filozofisë, psikologjisë e sociologjisë përftohen kahe studimi, teori e shkolla me përkatësi më të dukshme gjuhësore, psikologjike a socio-antropologjike, të cilat bëhen mbështetëse e nxitëse për shqyrtimet në nëndisiplina të caktuara të gjuhësisë së zbatuar, mbështetëse për zgjidhjen e problemeve konkrete që dalin a parashtrohen në ato disiplina.

Natyra transdisiplinore e dijeve të përfuara përmes këtij ndërveprimi ka mundësuar rryma a teori që studiuesit i grupojnë në mënyra të ndryshme, përgjithësisht në kuadër të teorive pragmatike.<sup>14</sup> Sipas P. M.-Akono-së, dallojmë *rrymën mepërkatësi psikologjike*, të përfaqësuar sidomos nga Shkolla e Palo-Altos (me studiues në zë si G. Bateson, D. Jackson e P. Watzlawick) që e sheh komunikimin verbal, joverbal e paraverbal të individit të lidhur ngushtë me grupin social që i përket; *rrymën e përkatësisë socio-antropologjike*, me prurje shkencore të etnografisë së komunikimit (sidomos me shqyrtimet e D. Hymes-it dhe J. Gumperz-it) që përqendrohet në aktet e komunikimit, bashkëmarrëdhëniet dhënës-marrës në komunikim përmes rregullave të komunikimit të brendshëm në grupin social; dhe analiza e bashkëbisedimit (H. Sacks, C.A. Schegloff dhe G. Jefferson), që interesohet jo vetëm për strukturat formale në komunikim, jo vetëm për reagimet e nxitura mes ndërvepruesve, por edhe për mekanizmat që marrin pjesë në përpunimin e një situatë komunikative; dhe së treti, *rrymat me përkatësi gjuhësore*, me teoritë e përpunuara në shkollën filozofike e pragmatike anglo-saksone për “aktet e ligjërimit” (me J. L. Austin-in, J. R. Searle-in e më tej D. Sperber-in e D. Wilson-in etj.), me përcaktimin fillimisht të akteve të ligjërimit (lokutiv, ilokutiv, perlokutiv) nga Austin-i dhe taksonominë e akteve të përvijuar nga Searle-i, si dhe një literaturë të bollshme në vijim; modelin semantiko-pragmatik të filozofit H. P. Grice, që priret të kapë synimin e projektuar nga folësi kur ngjiz gjuhësisht një thënie, duke ngulmuar në parimin e bashkëveprimit dhe maksimat bashkëbisedimore; dhe teorinë e enoncacionit, në shkollën gjuhësore franceze, që vë në qendër të shqyrtimit thënien, produkt të ndërveprimit mes gjuhës dhe kontekstit të thëniezimit (enoncacionit) (Mebiam-Akono, P., 2009:110-125), përmes së cilës “gjuhësia del prej getos së saj “imanentiste”: thëniet nuk janë më të shqyrtuara si njësi abstrakte, të zhveshura prej rrethanave në të cilat ato përftohen, prej situatës së të thënit, por

<sup>14</sup> Në veprën e tyre “Les grandes théories de linguistique, De la grammaire comparée à la pragmatique”, Armand Colin, 2011, autorët Marie-Anne Paveau e Georges-Élia Sarfati i kushtojnë një kapitull të veçantë (Kapitulli 11) këtyre teorive (faqe 206-236). Po ashtu edhe Pamphile Mebiam-Akono, në veprën e tij “De la Linguistique aux Sciences du Langage: évolution théorique d’une discipline”, L’Harmattan, 2009, i kushton kapitullin II, të pjesës III (faqe 105-134).

vëzhgohen si realitete të përcaktuara nga kushtëzimet që janë të pranishme në kontekstet e prodhimit e receptimit të tyre (Kerbrat-Orecchioni, C., 1990:9).

Ishte ky kontekst epistemologjik që nxiti e mundësoi që gjuhësia e zbatuar t'u përgjigjej kërkesave sociale për mësimdhënien e gjuhëve, ndërsa shoqëria i shtronte me përparësi përgjatë Luftës së Dytë Botërore<sup>15</sup>; apo më tej kur po zhbëhej sistemi kolonial në vitet 1960; ndërsa po shtohet interesimi për shqyrtimet në trajtimin automatik të gjuhëve e po zhvilloheshin teknologjitë e reja të përpunimit të të dhënave gjuhësore; kur po krijoheshin qendrat e gjuhësisë së zbatuar e trajtimin automatik të gjuhëve, që do të mundësonin më tej krijimin e shoqatave të gjuhësisë së zbatuar që do të bëheshin shprehëse të drejtpërdrejta të institucionalizimit social të kësaj fushe studimi.

Edhe pse tejet kalimthi, ngulmuam ta ndriçojmë kontekstin epistemologjik në të cilin u institucionalizua gjuhësia e zbatuar si fushë studimi, për të theksuar në këtë mënyrë edhe nevojën e zhvillimit më të plotë të këtyre dijeve shkencore në mendimin tonë gjuhësor, në mënyrë që të nxiten e mundësohen shqyrtimet më të plota, më të thelluara e më sistemore në studimet tona në gjuhësinë e zbatuar; të mundësohet edhe njëri prej funksioneve që ajo përmbush, “ndërmjetësimi” për të mundësuar zbatimin e atyre njohurive teorike të përvijuara në shkencat të ndryshme të ligjërimit në aktivitetin ligjërimor të shqipfolësve (por “ndërmjetësimi” bëhet i mundshëm kur dijet teorike në shkencat e ligjërimit janë të zhvilluara në masën e thellësinë e duhur; veçse të tilla ato mund të përdoren e përshtaten më tej në funksion të veprimtarisë sociale të individit e komunitetit gjuhësor).

• *Institucionalizimi i disiplinës shkencore a fushës së kërkimit si institucionalizim konjitiv dhe social përmes një akti performativ*

Siç vumë në dukje më lart, zbatimi i njohurive gjuhësore është ndërë si nevojë përgjatë tërë historisë së zhvillimit të mendimit gjuhësor. Përgjatë asaj historie është grumbulluar një përvojë e gjatë dhe e pasur e “disiplinimit” të prurjeve shkencore të kësaj natyre në formën e dijeve në fusha studimi a disiplina të tilla, si retorika, dialektika, didaktika e gjuhëve, traduktologjia, leksikografia etj. Në mënyrë të veçantë, në shekullin XX, mendimi gjuhësor

---

<sup>15</sup> Përmendet rëndom në literaturë se “interesi i amerikanëve për mësimdhënien e gjuhëve, mjaft i kufizuar deri atëherë, daton me disfatën e Pearl Harbour-it më 1941 dhe nevojën për t'u mësuar gjuhët e huaja ushtarakëve. Në mungesë të materialeve pedagogjike, gjuhëtarët u mobilizuan për të krijuar me ngut metoda, doracakë dhe programe për të dhënat e gjuhëve. Të frymëzuar prej parimeve dhe praktikave të antropologëve gjuhëtarë, domethënë prej përparësisë së gjuhës së folur dhe rëndësisë së folësit nativ (të cilit i duhej imituar sjellja për të kuptuar gjuhën), ato përvijojnë programe intensive trajnimi mbi bazën e ushtrimeve strukturore të frymëzuara nga folës nativë të gjuhëve” (shih Léon, J., 2011:71).

krijoi një kontekst nxitës e ndihmues për shqyrtimin e dukurive gjuhësore që përftoheshin e funksiononin të lidhura ngushtë me vetë proceset e përdorimit të gjuhës, pra për funksionimin më të efektshëm të akteve ligjërimore që kushtëzoheshin e ishin të lidhura ngushtë me situatat e të thënit (çka e çonte vëmendjen në veprimtarinë sociale të individit a komunitetit gjuhësor). Megjithatë, dijet e përfuara ndërkohë, në mënyrë që të integroheshin, madje specifikoheshin në një fushë të veçantë kërkimi shkencor, në një (meta-)disiplinë, do të duhej t'i nënshtroheshin *procesit të institucionalizimit*, sepse vetë nocioni “disiplinë shkencore”, “fushë e veçantë kërkimi shkencor” e parakupton këtë proces.

Duhet të theksojmë se disiplina, si tërësi dijesh të mirëpërcaktuara në lidhje me një objekt njohjeje (të përzgjedhur e ndërtuar me kujdes), të shqyrtuar përmes një metodologjie funksionale dhe një tërësie konceptesh e mbështetjeje teorike sa më të efektshme, përftohet si një “ngrehinë diskursive” në të cilën shqyrtohet objekti “i ndërtuar”, duke përvijuar në këtë mënyrë atë çka nga studiuesit emërtohet si *institucionalizimi konjitiv a intelektual*<sup>16</sup>; nga ana tjetër, disiplina është shfaqje domethënëse e kontributeve dhe interesimeve sociale të institucionalizuara që nxisin e mundësojnë kërkimin në fushën përkatëse; ky aspekt është gjithashtu parakusht i ekzistencës së disiplinës a fushës së studimit, i quajtur nga studiuesit *institucionalizimi social*<sup>17</sup>.

Pra disiplina shkencore (ose fusha shkencore e studimit) formësohet në dy aspekte: si entitet konjitiv (tërësi dijesh të përqendruara në ndriçimin e shqyrtimin e një objekti të veçantë njohjeje, çka mundëson autonominë e dijes së përfuar); dhe si dije që përfaqëson një autoritetet të institucionalizuar (pra njohje të qëllimtë, jo spontane e sidomos sisteme që ka të nevojshme kontributin social të institucionalizuar). Ky institucionalizim është një proces që parakupton një periudhë paraprijëse shqyrtimesh, një përvojë studimore të lidhur drejtpërdrejt me aspekte të caktuara të objektit të njohjes që sugjerohen nga vetitë e lëndës mbi të cilat ndërtohet objekti i njohjes. Është kjo përvojë studimore e përfuar, kjo vëmendje e përkujdesje e studiuesve a komuniteteve shkencore të caktuara, që u mundëson atyre që në një moment të volitshëm (kur

<sup>16</sup> Sipas Robert Boure-s, “me *institucionalizimin kognitiv ose intelektual* (ai i referohet edhe R. Whithley-t, që i përdor më parë këto koncepte, TP) duhet kuptuar formulimi i çështjeve të studimit, problematikat, konceptet dhe teoritë, përpunimi i metodologjisë, ndërtimi i objekteve, pranueshmëria e rezultateve dhe përcaktimi i fushës shkencore, pra përcaktimi i kufijve me disiplinat e tjera, kufij që janë njëherazi pengesë por edhe ndërlihdës” (Boure, R., 2005: 9-37, 11).

<sup>17</sup> Sipas autorit, “*institucionalizimi social* ka të bëjë me mënyrat e organizimit të studimit dhe mësimdhënies së dijeve të përfuara, me strukturat e sociale të nxitjes së vazhdueshme të studimit dhe ripërtëritjes së komunitetit të studiuesve, të legjitimitimit dhe ndihmës financiare për burimet, me përvijimin e programeve të kërkimit shkencor, me sistemet e publikimit” (Boure, R., 2005:11).

mjedisi social e intelektual e mundëson), ta shpallin ekzistencën e fushës së studimit në emër të një autoriteti diskursiv, në formën e një akti performativ. Më tej, prej këtij akti performativ “pagëzues”, procesi i institucionalizimit vijon të plotësojë përmasat e tij, çka përbën në fakt vetë plotësimin e dijes në atë fushë, dinamikën e zhvillimit të saj.

• *Tregues domethënës të institucionalizimit social të gjuhësisë së zbatuar*

Krijimi i institucioneve që do të angazhoheshin drejtpërdrejt në nxitjen e shqyrtimeve në këtë fushë studimi, organizimi i veprimtarive shkencore dhe dalja e revistave shkencore të specializuara për gjuhësinë e zbatuar janë tregues domethënës të suksesit të arritur në një kohë jo të gjatë në *institucionalizimin social* të gjuhësisë së zbatuar. Mbetet domethënëse kronologjia e disa prej ngjarjeve më të spikatura në fillimet e këtij procesi. Ja ç’mund të vinim në dukje në mënyrë të përmbledhur<sup>18</sup>:

1948, shfaqja e termit *Gjuhësi e Zbatuar* në kuadër të një programi për mësimdhënien e anglishtes (*English Language Teaching-ELT*) i organizuar nga Charles Fries-i në *Institutin e Gjuhës Angleze (English Language Institute)*, i themeluar më 1941 në universitetin e Miçiganit;

1957, krijimi i *Shkollës së Gjuhësisë së Zbatuar (School of Applied Linguistics)* në Universitetin e Edimburgut;

1958, krijimi i *Qendrës së gjuhësisë së zbatuar (Centre de linguistique appliquée)* në Bezanson nga Bernard Quemada, vijim i *Institutit të Gjuhës dhe Qytetërimit Francez (Institut de Langue et Civilisation Française)* krijuar nga B. Quemada në 1954-ën;

1959, krijimi i *Shoqatës për studimin dhe zhvillimin e Përkthimit Automatik dhe të Gjuhësisë së Zbatuar (Association pour l’étude et le développement de la Traduction Automatique et de la Linguistique Appliquée - ATALA)*;

1959, krijimi i *Qendrës për Gjuhësinë e Zbatuar (Center for Applied Linguistics – CAL)* në Universitetin e Miçiganit, të drejtuar nga Charles Ferguson dhe financuar nga fondacioni *Ford*;

1960, në kuadër të veprimtarive “Viti i Afrikës” (The year of Africa), *Konferenca për formimin dhe kërkimin universitar në përdorimin e anglishtes si gjuhë e dytë/e huaj (Conference on University training and research in the use of English as a second / foreign)*, organizuar nga Këshilli Britanik në Londër;

---

<sup>18</sup> Mes varianteve të shumta (më të hollësishme a më të përmbledhura) për ecurinë e krijimit të institucioneve që mundësuin institucionalizimin social të gjuhësisë së zbatuar, po japim këtë kronologji të shkurtër, që sipas autorëve të cilëve u referohemi, është ndër më të pranuarat (shih Linn, A. et al., 2011:13-14).

1961, konferenca e Komonuelthit mbi mësimdhënien e anglishtes si gjuhë e dytë, Makerere, Ouganda;

1962, publikimi i numrit të parë të *Studime të Gjuhësisë së Zbatuar (Etudes de Linguistique Appliquée)* të drejtuar nga B. Quemada;

1964, krijimi i *Shoqatës Ndërkombëtare të Gjuhësisë së Zbatuar* (e njohur më shumë me akronimin në frëngjisht AILA - *Association Internationale de Linguistique Appliquée* - ose *International Association of Applied Linguistics*) në kuadër të kolokiumit të Nancy-së (kryetari i parë: Bernard Pottier);

1964, krijimi i katedrës së parë të gjuhësisë së zbatuar në Universitetin e Essex-it (në Angli);

1965, krijimi i *Shoqatës Franceze të Gjuhësisë së Zbatuar (Association Française de Linguistique Appliquée-AFLA)*;

1967, krijimi i *Shoqatës Britanike të Gjuhësisë së Zbatuar (British Applied Linguistic Association-BAAL)* nga Peter Trevens dhe Michael Halliday mes të tjerëve; kryetari i parë është Pit Corder-i;

1968, krijimi i *Shoqatës për Gjuhësinë e Zbatuar (Gesellschaft für Angewandte Linguistik-GAL)*, Universiteti i Bayreuth-it (në Gjermani);

1977, krijimi i *Shoqatës Amerikane për Gjuhësinë e Zbatuar (American Association for Applied Linguistics-AAAL)*;

1980, dalja e revistës *Gjuhësia e Zbatuar (Applied Linguistics, Oxford University Press)* bashkëfinancuar nga shoqatat BAAL dhe AAAL;

1994, krijimi i *Shoqatës për Gjuhësinë e Zbatuar (Verband für Angewandte Linguistik)*, Universiteti i Vjenës (në Austri).<sup>19</sup>

Kronologjia e mësipërme na mundëson të vërejmë hapat e ndërmarrë në procesin e institucionalizimit social të kësaj fushe studimi, e cila legjitimohet tashmë nga prania e një strukturimi piramidial të përfutur nga *Shoqata Ndërkombëtare e Gjuhësisë së Zbatuar (AILA)*, me degë-bija të saj në vende të ndryshme të krijuara pothuaj në të njëjtën periudhë në disa vende europiane, me praninë e disa departamenteve të krijuara qysh në zanafillë të këtij institucionalizimi, me sistemin e ngritur të publikimit të revistave të specializuara për problematikën e saj në shqyrtim dhe veprimtaritë shkencore të po kësaj natyre etj. AILA është një strukturë e mirorganizuar tashmë, që ka arritur të zgjerojë bazën e saj. Le të theksojmë që më 1969-ën, shoqata përfshinte shoqata-bijë në 18 vende të botës, ndërsa aktualisht në mëse 35 vende të saj: Afrikë e Jugut, Australi, Austri, Belgjikë, Brazil, Estoni, Filipine,

<sup>19</sup> Sigurisht ka në këtë ndërkohë edhe ngjarje, botime, revista e veprimtari të tjera të rëndësishme që kanë ndikuar në institucionalizimin e kësaj fushe kërkimi, që mund të gjenden tashmë në botimet përkatëse, apo edhe në faqet zyrtare web të institucioneve në vende të ndryshme. Brenda hapësirës së kësaj trajtese, interpretimet do t'i mbështesim në të dhënat nga AILA dhe shoqatat e gjuhësisë së zbatuar në Francë, Britaninë e Madhe, Gjermani dhe SHBA, ndër shoqatat-bijë më aktive të AILA-s.



Finlandë, Francë, Greqi, Gjermani, Holandë, Irlandë, Itali, Izrael, Japoni, Kamerun, Kanada, Kinë, Kore e Jugut, Malajzi, Mbretëria e Bashkuar, Meksikë, Norvegji, Rusi, Serbi e Mali i Zi e Bosnjë-Herzegovinë, Singapor, Slloveni, Spanjë, Suedi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zelandë e Re, Zvicër. Është një institucion me objektiva të përcaktuara qartë në tri drejtime kryesore: 1. Të lehtësojë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e gjuhësisë së zbatuar; 2. Të nxisë e të bëjë të njohura studimet dhe mësimdhënien; 3. Të përhapë teoritë e reja të përvijuara në këtë fushë kërkimi (të dhënat për këtë shoqatë janë mbështetur në faqen web të AILA-s: <http://aila.info>).

Po kështu edhe shoqatat-bijë të saj në vende të ndryshme janë përfutur si institucione të legjitimuara me synime konkrete në këtë fushë studimi. *Shoqata Franceze e Gjuhësisë së Zbatuar* (AFLA) synon të përafrojë perspektivat shkencore të nxitura e përfuturara prej fushave të ndryshme të shkencave të ligjërimit për t'iu përgjigjur nevojave ekonomike e sociale përmes misionesh e bashkëpunimesh të mirëpërshtatura; bashkërendon studimet ndërdisiplinore dhe punën e kërkuesve në shkencat e ligjërimit që interesohen e përballen me kërkesat e veprimtarive sociale që kanë në bazë ligjërimit, pavarësisht nga sektori i veprimtarisë; vë në lidhje kërkues të specializuar me ndërmarrje, institucione, shoqata për t'iu përgjigjur nevojave që kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe përshtatjen e njohurive me njeriun (të dhënat për këtë shoqatë janë mbështetur në faqen web të AFLA-s: <http://www.afla-asso.org>); *Shoqata Britanike e Gjuhësisë së Zbatuar* (BAAL), e krijuar pas një tradite të spikatur të përvijuar në mësimdhënien e gjuhëve të huaja dhe përkthimin automatik, e ka zgjeruar fushën e zbatimit të njohurive të grumbulluara, duke pasur lidhje të ngushta me institucione dhe organizata që kanë interes të drejtpërdrejtë për gjuhësinë e zbatuar në Britaninë e Madhe (si me Akademinë e Shkencave Sociale; AILA-n, Akademinë britanike, Këshillin britanik; Komitetin e Gjuhësisë në Edukim; Këshillin Universitar të Gjuhësisë së Përgjithshme dhe të Zbatuar; Këshillin Universitar të Gjuhëve të Gjalla; e po ashtu ajo është e pranishme në Këshillin Konsultativ të revistës "Applied Linguistics" (Oxford University Press) (të dhënat për këtë shoqatë janë mbështetur në faqen web të BAAL-it: [baal.org.uk](http://baal.org.uk)); *Shoqata për Gjuhësinë e Zbatuar* (GAL), në Gjermani, është njëra prej shoqatave më të mëdha dhe më të vjetra të specialistëve të gjuhës të vendeve gjermanofone; ajo synon të nxisë veprimtari dhe nisma që kanë të bëjnë me studimin dhe përmirësimin e proceseve të komunikimit në jetën e përditshme dhe në fushat e zbatimit të profesioneve të ndryshme, duke u kushtuar një rëndësi e dorës së parë aktualisht edhe infrastrukturave numerike për gjuhësinë e zbatuar (të dhënat për këtë shoqatë janë mbështetur në faqen web të GAL-it: <http://www.gal-ev.de>).

Pjesë e institucionalizimit social të kësaj fushe studimi është edhe përvijimi i një sistemi funksional publikimi e paraqitjeje publike të prurjeve shkencore në këtë fushë, prej revistave të specializuara ndërkombëtare e

kombëtare, te botimet shkencore të specializuara për problemet e fushës dhe deri te veprimtaritë e ndryshme shkencore në plan ndërkombëtar, rajonal e kombëtar.

AILA boton “AILA News”, një buletin informativ që del tri herë në vit, dhe “AILA Review”, një revistë akademike që del një herë në vit.

BAAL-i në Mbretërinë e Bashkuar mundëson bashkërendimin e studimeve të kësaj fushe përmes publikimit të akteve të konferencave, botimit të një buletini informativ, dhënies së bursave për studentët, duke angazhuar mëse 1200 anëtarë.

GAL-i në Gjermani ka si botim kryesor serinë “Forum Applied Linguistics”- FAL, që kombinon monografi dhe vëllime të botuara mbi të gjitha subjektet e aktualitetit në gjuhësinë e zbatuar, të kuptuara si një fushë e veprimtarisë shkencore që trajton analizën dhe zgjidhjen e problemeve gjuhësore dhe të komunikimit në të gjitha fushat e ndërveprimit njerëzor dhe social në studimin, mësimdhënien dhe formimin e vazhdueshëm. Shumë e konsoliduar është edhe përvoja e botimit të revistave për gjuhësinë e zbatuar edhe në gjuhën frënge, në Francë, por edhe vende të tjera ku flitet frëngjisht, për shembull, në Zvicër, Kanada etj. (le të përmendim “Revue française de Linguistique Appliquée”, “Études de linguistique appliquée – revue de didactologie des langues-culture et de lexiculturologie” në Francë; “Bulletin suisse de linguistique appliquée” në Zvicër, “Revue Canadienne de linguistique appliquée” në Kanada etj.

Ky rrjet i botimeve shoqërohet edhe me veprimtaritë që kanë krijuar vijueshmëri e traditë tashmë. Veprimtaria më e spikatur e AILA-s është kongresi botëror i gjuhësisë së zbatuar, që bëhet çdo tre vjet (kongresi i radhës, i nëntëmbëdhjeti, është planifikuar të zhvillohet më 15-21 gusht 2021 në Groningen të Holandës (shih më gjerë <https://aila.info/19th-aila-world-congress//> dhe [aila2020.nl](https://aila2020.nl)).

Ndërsa BAAL-i, qysh prej 1967-ës, organizon një konferencë vjetore në të cilën jepen edhe tri çmime vjetore: për librin më të mirë, për artikullin më të mirë të një studenti të ciklit të tretë dhe për paraqitjen më të mirë të shfaqur në konferencë.

Të dhënat në faqet web të shoqatave të ndryshme kombëtare tregojnë për dendurinë e veprimtarive dhe vijimësinë e tyre, me mëtimin për t’iu përgjigjur problematikave që shfaqen në gjuhësinë e zbatuar në ditët tona.

Zhvillimi i veprimtarive në plan ndërkombëtar, rajonal e kombëtar ka nxitur komunitetin e studiuesve të kësaj fushe të rrisë rolin e tij në kontrollin e gjykimin e rezultateve të përfutuara dhe përhapjen e tyre, transmetimin dhe grumbullimin më të efektshëm të një literature të specializuar në mjedisin shkencor e atë universitar, për përvijimin e leksikut e terminologjisë së fushës, teorive dhe praktikave që lidhen me shfrytëzimin e teknologjive të reja.

Duke qenë një metadisciplinë, një fushë studimi ndërdisiplinore, madje transdisiplinore, diferencimi i këtij komuniteti shkencor shfaqet si një dukuri e ndërlikuar, që tërheq gjithnjë vëmendjen e studiuesve. Në fakt, çdo gjuhëtar mund të ndjehet edhe pranë gjuhësisë së zbatuar; nga ana tjetër, çdo studiues e gjuhëtar që interesohet veçanërisht për probleme të caktuara të gjuhësisë së zbatuar është natyrshëm pjesë e bashkësisë a komunitetit shkencor të gjuhëtarëve. Përcaktimi i fushës së drejtpërdrejtë të studimit dhe institucionalizimi social që përcakton institucionet e gjuhësisë së zbatuar bën në këtë rast dallimin e komunitetit të gjuhëtarëve zbatues.

Na duket se është domethënës paralelizmi që bëhet mes anëtarëve të AILA-s dhe studiuesve të angazhuar në shoqatat e gjuhësisë së zbatuar me status formal institucional në këtë fushë, me punonjësit e institucioneve të Komunitetit Europian në Bruksel, Strazburg a vende të tjera të zyrtarizuara në këto institucione (ndjesia e të qenit europian nga çdonjëri që e gjen veten pjesë të këtij kontinenti e qytetërimi, dallon nga statusi i pjesëtarëve të institucioneve të Komunitetit Europian; po ashtu, mëtimi se në studimet gjuhësore realizojnë edhe synime të gjuhësisë së zbatuar, dallon nga angazhimi institucional i studiuesve e specialistëve të shoqatave e organizmave të njohura institucionale të integruara edhe institucionalisht në këtë fushë studimi).<sup>20</sup>

• *Tregues domethënës të institucionalizimit konjitiv të gjuhësisë së zbatuar*

Mbeten po aq domethënëse edhe të dhënat për *institucionalizimin konjitiv/intelektual* të kësaj fushe studimi. Mund të vërehet pa vështirësi tashmë, se kemi të bëjmë me një fushë studimi në të cilën: është përcaktuar e qartësuar problematika, përmes formulimit të çështjeve konkrete (parashtrimi i çështjeve është po aq i rëndësishëm sa edhe zgjidhja e tyre në një fushë kërkimi); studimi përqendrohet në problemet e komunikimit të individit në mjediset sociale, pra në botën reale që ka në qendër gjuhën e ligjërimin; synohet të përpunohen metodologjitë sa më të efektshme në lidhje me këtë objekt

---

<sup>20</sup> M. Stegu bën një paralele domethënëse mes gjenezës së kombeve dhe identitetit kombëtar, nga njëra anë dhe gjenezës a zanafillës së disiplinave dhe “identiteteve disiplinore” nga ana tjetër. Ai thekson: “Ne mundet të jemi europianë edhe pa e pasur të shpallur zyrtarisht një identitet të tillë, siç mund të punojmë në një (nën-)disiplinë të gjuhësisë së zbatuar pa i ndjerë lidhjet e ngushta me *Gjuhësinë* e zbatuar si metadisciplinë. Nga një tjetër pikëvështrim, mundet ta vërenim tejet të shprehur identitetin europian më të spikatur te funksionarët e Bashkimit Europian dhe të Këshillit të Europës në Bruksel dhe në Strasburg, çka na bën të mendojmë për funksionarët e AILA-s dhe të shoqatave të tjera të gjuhësisë së zbatuar që do të jenë personat që do të identifikohen më shumë me “Gjuhësinë” e zbatuar si të tillë.” (Stegu, M., 2011: 133-134).

njohjeje; synohet përzgjedhja e përpunimi i koncepteve e teorive mbështetëse në shqyrtim (sigurisht, përzgjedhja e përpunimi i tyre kushtëzohet edhe nga konteksti epistemologjik në një kohë e hapësirë të caktuar - konteksti shfaqet funksional ose jo në një moment të caktuar dhe në aspekte të caktuara, ai i shpejton a i ngadalëson ritmet e institucionalizimit konjitiv të nëndisiplinave).

Kjo “ngrehinë diskursive”, që mundëson institucionalizimin konjitiv të gjuhësisë së zbatuar (dhe njëherazi mundësohet edhe nga institucionalizimi social), ka një strukturim të brendshëm ku gjallojnë e zhvillohen përvoja nga më të ndryshmet lokale, të kushtëzuara nga ritmet e ndryshme të këtyre dy aspekteve të institucionalizimit; por ato janë të kushtëzuara njëherazi edhe nga zhvillimet në kohë të traditave gjuhësore e teknologjike në vende të ndryshme, si dhe nga natyra e përparësitë e zhvillimeve të mendimit gjuhësor në ato përvoja, të kushtëzuara gjithashtu edhe nga roli e zhvillimi i disiplinave teorike të shkencave të ligjërimit a gjuhësisë (pa përjashtuar në këtë rast edhe rolin e studiuesve në zë të angazhuar që çojnë përpara fusha apo aspekte të caktuara të mendimit gjuhësor në një moment të caktuar të zhvillimit të tij).

Kështu, për shembull, nëse ndjehet si angazhim i përgjithshëm problemi i mësimdhënies e nxënies së gjuhë-s/-ve në të gjitha vendet, qasja nuk është e njëjtë në përvoja të ndryshme të gjuhësisë së zbatuar, sepse nxitjet nuk kanë qenë të njëjta. Përvoja e konsoliduar në vendet ku ky shqetësim është ndër më shumë dhe për të cilin është investuar më parë, për shembull në vendet anglishtfolëse (e theksuar së tepërmi në vitet 1960, kur ndodh procesi i shkolonializimit, që i dha nxitje punës së shoqatave anglosaksone të gjuhësisë së zbatuar), mund të ketë dallim me përvojën e grumbulluar në gjuhësinë gjermane, ku vëmendja ishte drejtuar qysh në vitet 1930 në gjermanistikë e gjuhësinë formale; apo me përvojën franceze, ku didaktika e gjuhëve ka mëtuar qysh herët të jetë një fushë e veçantë shkencore e sot zhvillohet nën emrin e didaktologjisë.

Në mënyrë të veçantë përvojat e vendeve të ndryshme dallojnë nga qasja ndaj dy problemeve qendrore të gjuhësisë së zbatuar në fillimet e saj: mësimdhënia e nxënia e gjuhëve dhe përdorimi i teknologjive të reja në përpunimin e të dhënave gjuhësore e në të ashtuquajturin “trajtimi automatik i gjuhëve”.

Por në hapësirat e asaj “ngrehine”, përvojat kombëtare kanë krijuar ndjeshmëri të ndryshme ndaj profileve të caktuara të objektit real, edhe si pasojë e pranueshmërisë së shqyrtimeve dhe “horizontit social të pritjes” për rezultatet e tyre në varësi të strukturës sociale të shoqërive përkatëse. Një shoqëri më heterogjene për nga përbërja e popullsisë, ka interesime e pritje të tjera ndaj studimeve në gjuhësinë e zbatuar, nga një shoqëri që nuk ka këtë strukturë. Forma dhe intensiteti i receptimit social të njohurive të përfutuara kanë ndikuar edhe në kahet e zhvillimit të këtyre njohurive në vende të

ndryshme, aq sa duket i motivueshëm edhe shtrimi i pyetjes nëse duhet të flasim për gjuhësinë e zbatuar, apo për gjuhësitë e zbatuara.

Kështu, për shembull, *Shoqata Amerikane për Gjuhësinë e Zbatuar* (*American Association for Applied Linguistics-AAAL*), degë-bijë e AILA-s, e krijuar më 1977-ën, përfshin në interesimet e saj 19 kahe shqyrtime, si: mësimdhënia dygjuhëshe e trashëgimisë dhe pakicave gjuhësore; njohja e ligjëritimit dhe studimi i trurit; gjuhësia e korpusit; analiza e diskursit dhe ndërveprimet; gjuhësia pedagogjike; gjuha, kultura, socializimi dhe pragmatika; gjuha dhe ideologjia; ruajtja dhe rigjallërimi i gjuhës; gjuha, planifikimi dhe politika; pedagogjia e gjuhëve të dyta dhe të huaja; metodologjia e kërkimit; të lexuarit, të shkruarit dhe alfabetizimi (mësimdhënia e tyre sipas grupeve sociale të caktuara); përvetësimi i një gjuhe të dytë; përvetësimi i gjuhës dhe pengesat; sociolinguistika; gjuha dhe teknologjia; përkthimi dhe interpretimi; analiza e tekstit (diskursit të shkruar); fjalori dhe studimet leksikore (të dhënat janë marrë nga

[https://fr.qaz.wiki/wiki/American\\_Association\\_for\\_Applied\\_Linguistics](https://fr.qaz.wiki/wiki/American_Association_for_Applied_Linguistics)).

Ndërsa seksionet e GAL-it në Gjermani, që paraqesin kahet e punës në gjuhësinë e zbatuar atje janë: komunikimi profesional; didaktika e medias dhe kompetencat mediatike; fonetika dhe shkencat e të folurit; kritika gjuhësore; studimi i bashkëbisedimit; komunikimi mediatik; të shkruarit shkencor; gjuhësia dhe stilistika e tekstit; komunikimi ndërkulturor; shumëgjuhësia; sociolinguistika; studimet për përkthimin dhe interpretimin; leksikografia; gjuhësia e migracionit; didaktika e gjuhëve. AFLA interesohet për të gjitha fushat që kanë të bëjnë me ligjërimin, me kahe të tilla, si: inteligjenca artificiale dhe gjuhësia komputacionale apo informatike; trajtimi automatik i gjuhëve; arsimimi/edukimi dhe barazia e shanseve; përvetësimi i gjuhës dhe nxënia e gjuhëve; teknologjitë numerike edukative; politika gjuhësore; gjuha e specialitetit dhe përkthimi (në fusha të tilla veprimtarie, si e drejta, mjekësia, inxhinieria, industrinë etj.); çrregullimet e të folurit; komunikimi dhe strategjitë e bashkëpunimit; analiza dhe përfitimi i sinjalit të të folurit; shërbimi i klientit dhe komunikimi në linjë; ligjërimi dhe shoqëria. Ndërsa BAAL-i përfshin këto kahe shqyrtime ose siç quhen ndryshe grupe të interesit të veçantë: gjuhësia e korpusit; anglishtja si gjuhë plotësuese; komunikimi në fushën e shëndetit dhe në shkencë; komunikimi ndërkulturor; gjuha, gjinia dhe seksualiteti; gjuha dhe mediat e reja; gjuha në Afrikë; nxënia dhe mësimdhënia e gjuhëve; politika gjuhësore; vendi i etnografisë gjuhësore; gjuhësia dhe njohuritë për gjuhën në edukim/arsimim; shumëgjuhësia; alfabetizimi profesional, akademik dhe në mjedisin e punës; studimet e fjalorit, etj.

Shprehëse domethënëse e gjerësisë dhe thellësisë së studimeve në këtë fushë janë studimet në revistat e specializuara në vende të ndryshme, të cilat përfaqësojnë përvojat, gjendjen e studimeve e sidomos perspektivat e shqyrtimeve në këtë fushë studimi, të lidhura njëherazi edhe me veçantitë e

atyre përvojave në hapësira e kohë të caktuara. Për të krijuar një ide për larminë e trajtimeve në to, po sjellin shembuj të botimeve të tri revistave në këto dhjetëvjeçarët e fundit.

Duke parë tematikën e numrave të botuar në vitet 2000-2020 të “Revue Française de Linguistique Appliquée” vërejmë një tematikë tejet të larmishme; madje vërehen trajtime të së njëjtës tematikë, të shqyrtuar nga pikëvështrime të ndryshme në numra të ndryshëm e vite të ndryshme. Spikatin tema të tilla, si: mësimdhënia dhe nxënia e gjuhëve<sup>21</sup>, leksiku, fjalorët dhe terminologjia<sup>22</sup>, përkthimi<sup>23</sup>, gjuhët e specialitetit<sup>24</sup>, shumëgjuhësia<sup>25</sup>, gjuha dhe konteksti social<sup>26</sup>, aftësia e njeriut për ngjizjen e transmetimin e informacionit përmes gjuhës<sup>27</sup>, gjuhësia dhe informatika<sup>28</sup> etj.

Në revistat e specializuara një vend i rëndësishëm u lihet problemeve të informatikës gjuhësore dhe teknologjive të reja në studimet gjuhësore. Vetëm në dhjetë vitet e fundit, në një prej revistave të rëndësishme të gjuhësisë së zbatuar në Francë, madje ndër të parat në këtë fushë studimi, themeluar qysh më 1962 nga B. Quemada, “Études de linguistique appliquée” - ELA (Revue de didactologie des langues-cultures et de lexiculurologie), për temën e

<sup>21</sup> 2002/2, Përvetësimi i gjuhëve: orientimet e reja; 2003/1, Vështrime të reja mbi të lexuarin e të shkruarin; 2006/1, Të mësosh gjuhët e huaja: tendencat aktuale; 2010/2, Të mësosh të shkruash: prurjet e teknologjive të reja; 2013/ Vlerësimi dhe mësimdhënia, ç’objektiva, me ç’mjete ?; 2015/2, Të dish të lexosh; 2016/2, Përvetësimi i gjuhëve të dyta, larmia e mënyrave të trajtimit; 2019/1, Vlerësimi në qendër të kërkimeve të tanishme.

<sup>22</sup> 2002/1, Leksiku, probleme aktuale; 2005/2, Fjalorët: mënyrat e reja të trajtimit, modelet e reja; 2007/2, Leksiku i shkrimeve shkencore; 2009/2, Orientimet e tanishme të terminologjisë; 2015/1, Leksiku, përshkrimi dhe të mësuarit; 2017/1, Larmia e burimeve leksikore: prej përpunimit në përdorimin e tyre.

<sup>23</sup> 2003/2, Përkthimi sot: teori dhe praktika; 2009/1, Gjuhësia dhe përkthimi; 2011/2, Konektorët: përshkrimi, përkthimi, të mësuarit.

<sup>24</sup> 2001/2, Gjuha dhe diskursi i specializuar; 2011/1, Gjuha dhe fusha e drejtësisë: terminologjia, përkthimi; 2014/1, Gjuhët e specialitetit: probleme dhe metoda.

<sup>25</sup> 2004/2, Shumëgjuhësia dhe politika europiane; 2006/2, Ndërveprimet gjuhësore; 2013/2, Gjuhët në kontakt; 2018/2, Shumëgjuhësia: larmia e mënyrave të trajtimit.

<sup>26</sup> 2000/2, Gjuha në kontekstin social; 2012/1, Gjuha e folur: norma dhe variacione; 2014/2, Gjuha faktor i integritit; 2017/2, Ndërveprimet sociale: studimet më të fundit për frëngjishten.

<sup>27</sup> 2001/1, Çrregullimet e ligjëritimit; 2008/1, Përfitimi i informacionit: prurjet e gjuhësisë; 2010/1, Të vlerësosh kompetencat ligjërimore; 2012/2, Ligjërimi dhe truri; 2018/1, Të dish të flasësh: prej perceptimit në ngjizjen gjuhësore.

<sup>28</sup> 2004/1, Gjuhësia dhe informatika: sfidat e reja; 2007/1, korpusi: bilance e perspektiva.

ndërmarrëdhënieve gjuhësi-informatikë janë botuar 8 numra të revistës kushtuar enkas kësaj tematike<sup>29</sup>.

Po ashtu e gjerë shfaqet kjo problematikë edhe në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të kaluar. Në vitet 1990, për shembull, në një periudhë dhjetëvjeçare (1990-2000), në “Buletinin zviceran të gjuhësisë së zbatuar” (Bulletin suisse de linguistique appliquée) kemi një tematikë të gjerë që përfshin tema të tilla të cilave u kushtohen numra të veçantë të revistës, si: mbi ndërveprimin (n° 57), mbi gjuhësinë tekstore (n° 61-64), mbi sociolinguistikën dhe gjuhët minoritare (n° 58 dhe 69), mbi dygjuhësinë dhe marrëdhëniet ndërkulturore (n° 54 dhe 65), mbi gramatikalizimin e formave femërore të emrave, mbiemrave e përemra që lidhen me profesionet, zanatet, titujt, gradat, funksionet (n° 72), mbi neurolinguistikën dhe patologjitë e ligjërimit (n° 66 dhe 68) (shih Pietro, XX 2002: 101-102).

Nuk duhet lënë pa përmendur edhe një tregues që ka të bëjë me institucionalizimin konjitiv, me historinë e këtij procesi: akti i krijimit të institucioneve përfaqësuese, i cili ka nevojë për kontekstin epistemologjik e social, por edhe për autoritetin diskursiv që mundësohet nga angazhimi i studiuesve më në zë të angazhuar në atë akt. Le të kujtojmë, për shembull, se AILA u shpall si e tillë më 1964-ën, në kuadër të një veprimtarie shkencore ndërkombëtare në Universitetin e Nancy-së, Francë, e përgatitur pas një pune gati dyvjeçare të drejtuar nga gjuhëtarët në zë Antoine Culioli dhe Guy Capelle; AFLA, e krijuar njëherazi me të në Nancy, Francë, në tetor të 1964-ës, me kontributin, përveç të tjerëve, të gjuhëtarëve me zë në Francë të kohës, Bernard Pottier, Paul Imbs, Jean Schneider, Yves Chalon; BAAL-i është themeluar në vitet 1960 (në vitin 1967 ajo bëhet degë-bijë e AILA-së), me propozimin e Peter Strevens-it që emërohet në atë periudhë në katedrën e Gjuhësisë së zbatuar të sapokrijuar në Universitetin e Essex-it. Në Gjermani, GAL-i u krijua me nismën e pjesëmarrjen e gjuhëtarëve anglicistë, gjermanistë, romanistë e specialistë të përkthimit që vinin nga përvoja studimore të suksesshme (shih Linn, A., et al., 2011:12); në Bashkimin Sovjetik të asaj kohe, arritjet në fushën e gjuhësisë së zbatuar mbështeteshin nga institucione të drejtuara nga personalitete të tilla, si Igor A.Mel’čuk (që drejtonte Institutin e Gjuhësisë së Akademisë së Shkencave në Moskë dhe Nikolaj D. Andréev në Universitetin e Leningradit); në Austri, kahet dhe arritjet e gjuhësisë së zbatuar

---

<sup>29</sup> 2009/4, Informatika dhe përshkrimi i gjuhës dje dhe sot; 2010/2, Informatika dhe didaktika e letërsisë; 2010/4, Studimet numerike/digjitale dhe mësimdhënia e frëngjishtes në universitet; 2012/2, Njohuritë e fshehura të zhvilluara nga të lexuarit dhe të shkruarit elektronik jashtëshkollor; 2015/4, Gjuhësia dhe informatika; 2018/4, Ndërtimi dhe transmetimi i njohurive të specializuara në web; 2019/1, Ta rimendosh studimin e gjuhës në universitet, sfida e studimeve numerike/digjitale në shkencat shoqërore; 2019/2, Fjalorët dhe kultura numerike/digjitale.

u formësuan nën ndikimin e fuqishëm të personalitetit të Ruth Wodak-ut, profesorja e parë e gjuhësisë së zbatuar në Austri dhe ndërkohë e njohur botërisht në fushën e analizës kritike të diskursit (shih Stegu, M., 2011:138). Asnjë disiplinë, pohon M. Stegu, “nuk është a priori “një disiplinë”, por ajo duhet më së pari të jetë e ndërtaur si e tillë. Një ngrehinë e tillë duhet të bazohet njëherazi mbi disa fakte që i konsiderojmë objektive – të tilla si ekzistenca e shoqatave, e kolokuiumeve, e departamenteve, e programeve të studimit etj., por “një disiplinë bëhet disiplinë në fund të fundit kur një grup që zotëron një lloj pushteti diskursiv e deklaron atë disiplinë me një akt ligjërimor performativ” (Stegu, M., 2011:130). Është akt formal, por që bart shumë domethënie dhe ndikim jo të vogël më tej.

- *Vijimi i diskutimeve në lidhje me statusin e fushës së studimit si tregues i zhvillimeve të brendshme në të*

Institucionalizimi konjitiv dhe social i fushës së studimit nuk i mbyll debatet e natyrës epistemologjike, por nxit në vijimësi rimarrje e riinterpretime të çështjeve të ndryshme që lidhen me karakterin shkencor të prurjeve në një periudhë të caktuar të zhvillimit të dijes. Në lidhje me gjuhësinë e zbatuar vijojnë të diskutohen e riinterpretohen çështje të tilla që kanë të bëjnë me natyrën e dijeve të përfuara në këtë fushë, zhvillimet e brendshme të nëndisiplinave që gjallojnë në përbërje të saj, prirjet e disa nëndisiplinave për t’i kapërcyer varësitë brenda fushës e për të siguruar autonomi, peshën e teorizimeve brenda hapësirës së shkencave të zbatuara, peshën e traditës së mendimit gjuhësor, të përvojave të ngulitura në shqyrtime dhe kahet më shprehëse që zhvillohen në vendet përkatëse të ndikuara nga këto tradita, veçantinë e punës së studiuesit të angazhuar drejtpërdrejt në këtë fushë studimi etj.

Në fakt, institucionalizimi konjitiv e social i fushës së dijes ndihmon të theksohen kufijtë e (meta-)disiplinës, duke bërë tejet të dukshme hapësirat e zotëruara prej saj në shkencat e ligjërimit, por ndihmon njëherazi të theksohen kufijtë edhe të (nën-)disiplinave të asaj (meta-)disipline, duke ndriçuar së brendshmi edhe dinamikën e zhvillimit të tyre; e në këtë mënyrë, edhe veçantitë e nëndisiplinës e ngjashmëritë me të përafërtat e saj. Përforcimi i kufijve të fushës së studimit që mundësohet nga institucionalizimi gjithnjë e më i plotë dhe zhvillimet e brendshme në nëndisiplina të ndryshme nxisin në vijimësi çështje të natyrës epistemologjike, trajtimi i të cilave tregon sërish gjallërinë dhe perspektivat e zhvillimit të kësaj dijeje.

Vijojnë diskutimet, nëse në ditët tona apo në të ardhmen gjuhësia e zbatuar do të ruajë statusin e një fushe studimi autonome, do të vijojë të jetë një meta-disiplinë me nëndisiplinat përbërëse, apo disa prej tyre do të fitojnë autonomi dhe do të funksionojnë si disiplina më vete, autonome (të mos harrojmë se



autonomia u mundëson atyre edhe burime financiare më të shumta e më të sigurta). Përgjithësisht studiuesit bien në një mendje se në fazat e para të institucionalizimit të saj gjuhësia e zbatuar funksiononte si një fushë autonome, si një meta-disiplinë, me nën-disiplina përbërëse; por ata vërejnë gjithnjë e më shumë prirjen për autonomi të disa disiplinave në gjë të saj, si për shembull traduktologjia, didaktika e gjuhëve etj. Edhe themelues të kësaj fushe studimi, si M. Halliday, i qëndrojnë idesë se “në vitet 1960, gjuhësia e zbatuar përvijohet si ndërmarrje për “zgjidhjen e problemit”, e destinuar të trajtojë “problemet bazë që kanë të bëjnë me ligjërimin në përdorim”, por aktualisht duhet të mbajmë parasysh se “gjuhësia punon mbi ligjërimin si objekt studimi, ndërsa gjuhësia e zbatuar punon mbi ligjërimin si një çështje, një subjekt mbi të cilin ushtrohet aktiviteti i njeriut” (shih Léon, J., 2011: 79).

Po ashtu, mbetet pjesë e diskutimeve të sotme interpretimi i raportit të përfutur mes statusit ndërdisiplinor (shumëdisiplinor) dhe karakterit shkencor të dijeve të përfutura në këtë fushë. Zhvillimet e sotme jo vetëm në gjuhësinë e zbatuar, por në tërësi në shkencat e ligjërimin po nxisin natyrshëm idenë që edhe gjuhësia nuk ka pse të mbetet e konsiderohet njëdisiplinore, ngaqë “nuk ka asnjë rregull absolute që të thotë që gjuhësia do të duhet të mbetet gjithnjë një disiplinë “njëdisiplinore”. Përkundrazi, qysh prej kohësh ekzistojnë disiplina të tilla [...] si socio- dhe psikolinguistika, edhe pse ato kanë guxuar të përfshijnë metoda të sociologjisë dhe të psikologjisë” (Stegu, M., 2011:135).

Duke qenë edhe në emërtim një disiplinë e zbatuar, mbetet pjesë e diskutimeve roli që luan teoria në shqyrtimet e bëra; gjithnjë e më shumë studiuesit janë të mendimit që në hapësirën e kësaj fushe studimi jo vetëm zbatohen teoritë e përfutura në disiplina të tjera, jo vetëm kemi mjetet e ndërmjetësimit për zbatimin e teorive, por përftohen teori e teorizime edhe brenda kësaj fushe. Madje ka qëndrime edhe më optimiste ku theksohet se “në përgjithësi, në gjuhësinë e zbatuar, nuk diskutohet më për çështjen nëse “kemi teori ose jo”, por shtrohet më shumë çështja se cilat janë teoritë me të cilat do të duhet të punojmë, teoritë ekzistuese ose që mbeten për t’u zhvilluar” (Stegu, M., 2011:133). Madje qysh me Ruth Wodak-un, mund të dallohet një “gjuhësi e zbatuar teorike” (TAS, Theoretische Angewandte Sprachwissenschaft”) prej një “gjuhësie të zbatuar zbatuese” (AAS, “Angewandte Angewandte Sprachwissenschaft”), një zgjidhje terminologjike e kuptueshme, e qartë, megjithëse disi irrituese dhe e diskutueshme”, që ndoshta do të ishte më mirë “gjuhësi e zbatuar e prirur drejt zbatimit” (shih, Stegu, M. 2011:132). Studimet e sotme i bëjnë gjithnjë e më të prekshme të dyja këto përvoja. Shembuj të shumtë sillen për prirjen drejt teorizimeve gjuhësore në fusha të tilla si didaktika e gjuhëve, përkthimi, analiza kritike e diskursit etj.

Duke përfaqësuar një komunitet të veçantë studiuesish, statusi i gjuhëtarit zbatues po qartëson gjithnjë e më shumë profilet e tij në raport me dijen e përfutur, e po ashtu edhe bashkëpunimin me specialistët, prakticienët e

komunikimit në përfitim të produkteve. Veçantia e studimit dhe punës së një gjuhëtari të angazhuar në problematikën e gjuhësisë së zbatuar, e cila objektin e studimit e përfiton nga një kërkesë që vjen së jashtmi, nga një nevojë sociale, nga nevoja për të ndihmuar e përsosur komunikimin në veprimtaritë sociale, krijon parakushte për të tjera qasje në shqyrtim. Ndaj gjuhëtari zbatues duhet “të njohë e marrë në shqyrtim kërkesën që vjen së jashtmi, duhet të vlerësojë mundësinë e interpretimit përmes koncepteve të gjuhësisë (duke ndërtuar një problematikë gjuhësore), duhet të kërkojë studimet ekzistuese, të ndërtojë një objekt studimi (duke mbajtur parasysh kërkesën e parashtruar dhe studimet ekzistuese), ta analizojë këtë objekt, t’ua propozojë rezultatet kërkuesve e të interesuarve, t’i vlefshmojë këto rezultate duke patur parasysh kërkesën e të interesuarve (atë kërkesë që erdhi së jashtmi) dhe dijet gjuhësore, t’i përfshijë më tej rezultatet në paradigmen a modelin gjuhësor” (Condamines, A. et Narcy-Combes, J.-P., 2015:9)<sup>30</sup>.

Vijimi i diskutimeve të tilla veçse thëllon më tej mëtimet e kësaj fushe studimi në funksion të zgjidhjeve të problemeve që shoqëria parashtron për aktivitetin ligjërimit. Na duket nxitëse ideja që këto diskutime veçse e përforcojnë statusin e saj, sepse “gjuhësia e zbatuar nuk është asnjë prej të gjitha këtyre ose fare mirë ajo është të gjitha këto njëherazi: ajo s’është gjë tjetër veçse sinteza e gjithçkaje çka ka qenë thënë a shkruar për të dhe ajo çka do të jetë thënë e shkruar ndërkohë” (Stegu, M., 2011: 138).

• *Mbi institucionalizimin konjitiv e social të gjuhësisë së zbatuar në mjedisin shkencor shqiptar*

Të dhënat për kontekstin epistemologjik në të cilin u institucionalizua fusha e gjuhësisë së zbatuar dhe të dhënat për çështjet që shqyrtohen në ditët tona në vende të ndryshme mund të shërbejnë gjithashtu si një pamje prej së

<sup>30</sup> Autorët nënvizojnë në këtë rast edhe natyrën jo të njëjtë të vlerësimit të rezultateve në gjuhësinë teorike dhe atë të zbatuar. Sipas tyre “nëse në studimet teorike vlerësimi është i lidhur me pritjen dhe pranimin nga studiuesit e tjerë (“po, këto rezultate përfshihen si vijim i studimeve të mëparshme dhe duken të vlefshme”); për shqyrtimet e produktet e përfutura në gjuhësinë e zbatuar vlerësimi është i dyfishtë: nga studiuesit, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, nga të interesuarit që kishin parashtruar kërkesën së jashtmi si nevojë të veprimtarisë sociale apo nga të interesuarit në fusha të tjera të veprimtarisë shkencore që kanë nevojë për konceptet gjuhësore, për shembull, inxhinierët, matematikanët, informaticienët që punojnë me programimet gjuhësore”. Për të përmbushur sa më mirë ato kërkesa, “do të duhet të përftohet një bashkëmarrëdhënie mes kompetencave të të interesuarve me kompetencat e gjuhëtarëve. Flitet pra për bashkëndërtim të objektit, që ushqehet prej kompetencave të ndryshme në dispozicion, që mundësojnë të evoluojë reflektimi, domethënë të përparojë drejt një rezultati që merr parasysh njëherazi kërkesën fillestare dhe njohuritë mbi funksionimin e gjuhës” (Condamines, A. et Narcy-Combes, J.-P., 2015:9).

cilës mund të ndihmohemi për ndriçimin më të plotë të kontekstit epistemologjik në të cilin janë zhvilluar, zhvillohen e duhet të zhvillohen shqyrtimet në mendimin gjuhësor shqiptar. I zhvilluar në kushte disi më të veçanta, ndërsa ndikimet e gjuhësisë strukturaliste dhe asaj funksionale nuk kanë qenë të shprehura qartë (megjithëse të pranishme e të dobishme edhe në këto shqyrtime), ndërsa po zhvillohen po ashtu edhe shqyrtime të vlefshme në kuadër të kaheve a modeleve të ndryshme të shkencave të ligjërimit (edhe pse vëmendja ndaj dukurive që lidhen me diskursin, tekstin etj. ende nuk ka zënë vendin e duhur në interesimet e gjuhëtarëve shqiptarë), gjithsesi është e nevojshme ta ndriçojmë sa më qartë këtë mjedis, në mënyrë që të përcaktojmë strategjinë e zhvillimit të këtyre disiplinave, e në këtë mënyrë edhe të gjuhësisë së zbatuar.

Në mendimin gjuhësor shqiptar kanë qenë prej kohësh të pranishme përpjekjet për shqyrtime në fushën e gjuhësisë së zbatuar; herë në mënyrë të ndrojtur e herë të tjera në mënyrë më të sigurt janë hedhur hapa të suksesshëm në sektorë të ndryshëm të kësaj fushe studimi<sup>31</sup>.

Prej kohësh emërtimi “gjuhësi e zbatuar” është i pranishëm në trajtesat e ndryshme të gjuhëtarëve shqiptarë. Studime të ndryshme, botime shkencore e teza doktorate janë përqendruar në aspekte a tema që përfshihen në problematikën e gjuhësisë së zbatuar (kryesisht në problematikën që lidhet me mësimdhënien e shqipes, hartimin e fjalorëve e terminologjinë, por edhe në problematikën që lidhet me zbatimin e dijeve të gjuhësisë përmes teknologjive të reja në shkrimin sa më të drejtë me anë të programeve kompjuterike); në disa universitete, pranë departamenteve të gjuhësisë ekzistojnë seksionet e gjuhësisë së zbatuar, si struktura që mundësojnë mësimdhënien e dijes së kësaj fushe studimi; po ashtu pranë Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) ekziston prej disa vitesh një seksion i veçantë i studimeve në fushën e gjuhësisë së zbatuar, në përbërje të departamentit të leksikologjisë e terminologjisë, siç funksionon gjithashtu një komision i posaçëm “Gjuha në shkollë”, pranë Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe (Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës).

Të angazhuar kryesisht në studimin e shqyrtimin e dukurive gjuhësore në nënsisteme të ndryshme të shqipes, në atë fonetik, morfo-sintaksor, leksikor e semantik, gjuhëtarë në zë shqiptarë, njohës të mirë të teorive bashkëkohore, duke u nisur prej dukurive të shqipes, kanë hedhur vështrimin në gjuhësinë e përgjithshme e po ashtu edhe ndaj qasjeve zbatuese. Një përvojë e vyer është grumbulluar ndërkohë në hartimin e teksteve shkollore të gjuhës shqipe, qysh nga abetarja dhe tekstet e gjuhës shqipe në sistemin shkollor parauniversitar e

---

<sup>31</sup> Për arritjet në disa prej apekteve të studimit në këtë fushë, shih edhe Hoti (Muka), I., 2013; Gjokutaj, M., Hoti, I., 2014; Plangarica, T., 2002.

deri në gramatikën praktike të shqipes (pjesëmarrja e profesoratit të departamenteve të gjuhësisë të universiteteve në hartimin e teksteve shkollore të gjuhës e letërsisë, e cila priret shkallë-shkallë të përvijojë një gramatikë shkollore të shqipes, është tregues i zhvillimeve në këtë fushë); po ashtu vëmendje e posaçme i është kushtuar prej tyre studimit të standardit gjuhësor e politikave gjuhësore që ndikojnë në formësimin e përsosjen e tij, krahas studimeve në fushën e sociolinguistikës, psikolinguistikës etj.

Njohja e përvojave të përfuara tashmë e sidomos diskutimi shkencor në lidhje me produktet e përfuara është i domosdoshëm për ndriçimin e kontekstit epistemologjik në të cilin do të mund të zhvillohen më tej studimet në gjuhësinë e zbatuar, sidomos për të shfaqur më dukshëm hapësirat që duhen plotësuar me studime qoftë në aspektin teorik, qoftë atë të zbatuar (shmangia në diskutim e këtij konteksti na pengon për ta parë më qartë edhe vetë hapësirën në të cilën do të duhet të përfshihen a ndërfiten shqyrtimet e gjuhësinë së zbatuar).

Diskutimi dhe debati shkencor në lidhje me gjuhësinë e zbatuar në kontekstin e mendimit tonë gjuhësor, duhet t'i shërbejë synimit më afatgjatë, "ndërtimit" të një strategjie për institucionalizimin real dhe funksional të kësaj fushe dijeje në zhvillimet tona të ardhshme.

Në fakt, hapat e parë për nxitjen e debatit shkencor janë lehtësisht të kapteshëm, sepse në literaturën që i kushtohet kësaj problematike ka informacion të bollshëm dhe trajtesa të larmishme që e kanë ndriçuar këtë problematikë nga profilet nga më të ndryshmet të shfaqjes e ekzistencës së saj. Duhet veçse vullnet e angazhim i studiuesve që kjo problematikë të gjallojë e nxisë edhe më gjerë trajtesat në institucionet tona shkencore. Më e rëndësishme dhe më e vështirë është të përdoret kjo përvojë për studimet tona dhe kahet që duhet të hapen gradualisht për nevojat që parashtrihen për gjuhësinë e zbatuar nga mjedisi social shqiptar. Do të duhet që të njihet "lënda shqiptare" që do të përbëjë më tej "objektin e ndërtuar" të studimeve tona të gjuhësisë së zbatuar. Njohja e kësaj "lënde" dhe "ndërtimi i objektit" nga studiuesit tanë kërkon mund, punë, institucione të ngritura e në funksionim e sipër, financim, pra një mjedis të tërë favorizues që ka vështirësitë e veta të përvijimit.

Do të duhet pra të mendohet më seriozisht për institucionalizimin sa më të plotë të kësaj fushe studimi.

Në lidhje me institucionalizimin konjitiv janë disa kahe të rëndësishme që kërkojnë shqyrtimin me përparësi të nevojave të shoqërisë e përkujdesjen e shtuar nga ana e studiuesve të angazhuar në gjuhësinë e zbatuar, të tilla si mësimdhënia e nxënia e gjuhëve, për të përcaktuar prurjet shkencore të sotme të gjuhësisë së zbatuar në funksion të përsosjes së kësaj veprimtarie (dhe lidhur ngushtë me të, shqyrtimet në shkencat e ligjërimit për dukuritë e shqipes në funksion të përdorimit të saj në situata të ndryshme komunikative); fusha e përkthimit, jo vetëm e letërsisë artistike, por edhe fushave të tjera të

veprimtarisë sociale në të cilat shqipja po përballet me nevojat e përpunimit të shprehjes, të mjeteve gjuhësore për ta bërë ligjërimin në to sa më funksional; fusha e terminologjisë që përbën një front të gjerë pune e studimesh në këto kohë të zhvillimeve të vullshme të shkencës e teknikës; fusha e përpunimit informatik të të dhënave gjuhësore për hartimin e disiplinimin e të dhënave të korpusit të shqipes së folur, e po ashtu për hartimin e fjalorëve elektronikë të natyrave të ndryshme, për të arritur deri në hartimin e tipit “lexibook” (Linguistic Electronic System) të produkteve elektronike për publikun e gjerë (duke i dhënë përparësinë e duhur edhe përgatitjes së korrektorëve elektronikë gramatikorë e drejtshkrimorë, si mjete të përditshmërisë në përdorimin e shqipes); fusha e shqyrtimit të të dhënave gjuhësore për “gjuhët e specialitetit” dhe ligjërimin në sektorë të caktuar të punës sipas profesioneve e grupimeve të ndryshme profesionale; fusha e statistikës gjuhësore dhe përpunimit të të dhënave gjuhësore për nënsistemet e ndryshme të shqipes; fusha e studimit që ka të bëjë me patologjitë e çrregullimet e të folurit në grupmosha të caktuara etj.

Siç mund të vërehet nga nevojat e parashtruara, përmbushja e misionit parakupton angazhime jo vetëm të gjuhëtarëve të interesuar që punojnë drejtpërdrejt në këto drejtime të kësaj fushe studimi, por edhe të gjuhëtarëve që kontribuojnë në disiplina të tjera të shkencave të ligjëritit dhe mundësojnë studimet në fushën e gjuhësisë së zbatuar; e veçanërisht edhe të studiuesve, specialistëve, inxhinierëve, teknikienëve, informaticienëve që punojnë në fushat e programimit, të informatikës e teknologjive të reja të komunikimit, pa ndihmën e kontributin e të cilëve arritjet do të ishin të pamundura. Harmonizimi i përpjekjeve në këtë komunitet të gjerë studiuesish, kërkuesish, specialistësh e teknikienësh do të mundësonte institucionalizimin më të plotë të kësaj fushe studimi në mendimin gjuhësor shqiptar, e një vend të merituar të gjuhësisë së zbatuar në shkencat e ligjëritit për shqipen.

Por kërkesat e parashtruara për institucionalizimin konjitiv të dijeve e prurjeve shkencore në këtë fushë parakuptojnë, nga ana tjetër, edhe hapat që duhen ndërmarrë për institucionalizimin më të plotë social të gjuhësisë së zbatuar në mjedisin tonë. Janë të ngutshme hapat që duhen ndërmarrë për të përfaqësuar institucionalisht komunitetin shkencor të kësaj fushe studimi përmes krijimit të shoqatës a qendrave të kërkimit të gjuhësisë së zbatuar shqiptare, sipas modeleve të suksesshme që ekzistojnë tashmë në shumë e shumë vende të botës, e për më tepër, pothuaj në të gjitha vendet e Ballkanit; si dhe përfshirja e kësaj shoqate si shoqatë-bijë e AILA-s, çka do të zgjeronte mundësitë e bashkëpunimit e shfrytëzimit të përvojave të vendeve të tjera në dobi të shqyrtimeve për gjuhën shqipe. Përfshirja e komunitetit të studiuesve të kësaj fushe në institucione të kësaj natyre do të nxiste e mundësonte zhvillimin e veprimtarive më të programuara shkencore, e në këtë mënyrë do të zgjonte vëmendjen e të interesuarve për prurjet shkencore e praktike në fusha të ndryshme të veprimtarive sociale që kanë në bazë gjuhën/ligjërimin, e për

pasojë, do të mundësonte më shumë burime financimi për kërkimin shkencor në këtë fushë.

Është e ngutshme, nga ana tjetër, që ky komunitet kërkuesish të ketë organin (apo organet e specializuara të botimit), pra revistën (a revistat) ku do të pasqyroheshin në vijimësi rezultatet e punës shkencore në të gjithë hapësirën e përdorimit e studimit të shqipes (ku mund të zinin vend edhe prurjet shkencore bashkëkohore nga përvojat e vendeve të tjera). Mbetet e domosdoshme, gjithashtu, që pjesë e këtij institucionalizimi të jetë ngritja a përforcimi i departamenteve a seksioneve të gjuhësisë së zbatuar në universitetet shqiptare, çka do të mundësonte jo thjesht dhënie njohurish në këtë fushë studimi, por njëherazi edhe studim, kërkim shkencor e produkte konkrete me vlerë për fusha të ndryshme. Natyrshëm këto studime e produkte shkencore do të rrisnin më tej trysninë për t'u bërë pjesë e politikave të mediave të folura e të shkruara. Duhet të rritet kjo trysni, në mënyrë që vëmendja e shoqërisë dhe institucioneve që lidhen me këtë fushë studimi dhe që përfitojnë prej studimeve të saj të drejtohet nga produktet e saj e të mos lërë në harresë idetë, projektet e synimet e studiuesve që jo pak herë janë shprehur publikisht, por nuk kanë ndikuar te politikëbërësit e politikës gjuhësore. Produktet e gjuhësisë së zbatuar e shpërblejnë investimin e shoqërisë, mundin dhe punën e studiuesve, por ky kompensim vjen veçse pas investimit e konsumimit paraprak të përpjekjeve që duhen bërë. Sa më të qartë e të organizuar institucionalisht të jemi në hapat që do të ndërmarrim, aq më shpejta dhe më të pjekura do të jenë frytet e shpresuara. Paradigma a modeli i shkencës në ditët tona nuk është fryt vetëm i talentit e përkushtimit të individit, por një bashkëmarrëdhënie e këtyre treguesve (të domosdoshëm) me komunitetin shkencor e social. Kjo bashkëmarrëdhënie do të na mundësojë ta mënjanojmë ritmin e pakënaqshëm të zhvillimit shkencor në njërin a tjetrin sektor të kërkimit, edhe pse në një kohë a hapësirë të caktuar kemi e do të kemi studiues të talentuar a mendje të ndritura mes nesh.

- *Në mbyllje*

Është mëtim i natyrshëm i kërkimit shkencor që dija, përmes zgjerimit e thellimit të njohjes në lidhje me dukuritë që kanë të bëjnë me jetën e njeriut, t'u paraprijë nevojave të së ardhmes; dhe shkenca e bart këtë mision. Por është, nga ana tjetër, mision po aq madhor i dijes shkencore, sidomos asaj të zbatuar, që t'u përgjigjet kërkesave aktuale të shoqërisë, ritmeve të saj të zhvillimit dhe të lehtësojë veprimtarinë e individit e komunitetit në përditshmërinë e aktivitetit të tyre. Fusha të tilla studimi e kërkimi si gjuhësia e zbatuar lindin e zhvillohen në radhë të parë nga nevojat e përditshmërisë së njerëzve. Vonesat a ngadalësia në zhvillimin e gjuhësisë së zbatuar kanë ndikim të drejtpërdrejtë për të tashmen, e natyrshëm edhe për ardhmërinë e individëve e komuniteteve

të ndryshme sociale, për vetë natyrën e veçantitë e problemeve që ajo studion e natyrën e produkteve e prurjeve të saj. Ndaj edhe në mendimin tonë shkencor, ritmet e zhvillimit të gjuhësisë së zbatuar duhen vlerësuar duke patur parasysh këto funksione që ajo bart/duhet të bartë, me këtë veçanti të dobishmërisë sociale. Mungesa e vëmendjes dhe zhvillimi spontan është borxh që mendimi gjuhësor i mbetet shoqërisë, madje një borxh i pajustificueshëm në kontekstet e sotme të zhvillimit të shkencës e shoqërisë.

## **BIBLIOGRAFI**

- Aroux, S., *Le mode d'existence de la "langue"*, in "La linguistique aujourd'hui, Fondement & domaines.", volume 49, fascicule 1, 2013, Presses Universitaires de France, Paris, 11-33.
- Benveniste, É., *Problèmes de linguistique générale*, 1, Éditions Gallimard, 1966.
- Bramfit, Ch., *Haw applied linguistics is the same as any other science*, in "International Journal of Applied Linguistics", 7/1, 1997, 86-94.
- Bouchard, R., *Les linguistiques appliquées et les sciences du langage*, in "Actes du 2<sup>ème</sup> Colloque de Linguistique Appliquée", Université de Strasbourg 2, Decembre, 1998).
- Boure, R., *Réflexions autour de l'institutionnalisation des disciplines, Sciences de l'information et de la communication versus économie?*, në "Communication", vol. 24/1- 2005.
- Carnino, G., *Louis Pasteur. La science pure au service de l'industrie*, in "Le mouvement social", 2014/3, n° 248, 9-26, në linjë: cairn.info. 08/09/2014.
- Condamines, A. et Narcy-Combes, J.-P., *La linguistique appliquée comme science située* in F. Carton; J.-P. Narcy-Combes; M.-F. Narcy-Combes; D. Taffoli, "Culture de recherche en linguistique appliquée", Riveneuve éditions, 2015; [edhe në linjë, HAL Id:hal-01286390], faqe 1-16.
- Fabiani, J.-L., *À quoi sert la notion de discipline ?* in "Qu'est-ce qu'une discipline ?", Edition de l'École des Hautes Études en Sciences Sociales, Collection "Enquête", 2006.
- Fourez, G., Maingain, A. et Dufour, B., *Approches didactiques et interdisciplinarité*, Bruxelles, Belgique: De Boeck, 2002.
- Gjikutaj, M., Hoti, I., *Çështje të trajtimit të gjuhësisë së zbatuar para dhe pas viteve '90 në gjuhësinë shqiptare*, kumtesë në "Seminari XXXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Prishtinë, 18-30.8.2014.
- Histoire, Épistemologie, Langage, tome 33, fascicule 1, 2011, i konsultueshëm edhe në linjë, në [https://www.persee.fr/doc/hel\\_0750-8069\\_2011\\_num\\_33\\_1\\_3202](https://www.persee.fr/doc/hel_0750-8069_2011_num_33_1_3202).

- Hoti (Muka), I., *Gjuhësia e zbatuar përmes kurrikulës së gjuhës shqipe* (Monografi), *Për studentët dhe mësuesit e gjuhës shqipe*, Shtëpia Botuese “Progresi”, Janar 2013.
- Kerbrat-Orecchioni, C., *Les interactions verbales*, tome I, Paris, Armand Colin, 1990.
- Lazard, G., *Réflexions séculaires et La linguistique aujourd’hui, Observation mutuelles* in “La linguistique aujourd’hui, Fondement & domaines.”, volume 49, fascicule 1, 2013, Presses Universitaires de France, Paris, faqe 49-65; 163-168.
- Lenclud, G., *Les incertitudes de la notion de science appliquée*, in “Les applications de l’anthropologie; un essai de réflexion collective depuis la France”, sous la direction de Jean-François Baré et al. 1995 – version électronique légèrement remaniée, 2008, faqe 49-63.
- Léon J., *De la linguistique descriptive à la linguistique appliquée dans la tradition britannique: Sweet, Firth et Halliday*, in *Histoire, Épistémologie Langage*, tome 33, fascicule 1, 2011, faqe 69-81.
- Levy, P., *La place de la médiologie dans le trivium*, Gallimard “Les cahiers de médiologie”, 1998/2, N° 6, 43-58 (en ligne: cairn.info pour Gallimard, Matières réflexion).
- Linn, A., Candel, D., Léon, J., *Présentation: Linguistique appliquée et disciplinarisation*. In: “Histoire Epistémologie Langage”, tome 33, fascicule 1, 2011, faqe 7-14.
- Llewellyn Smith, C. H., *A quoi sert la recherche fondamentale? Science fondamentale et science appliquée*, në web communication, DSU-CO, 2008 <http://home.cern>
- Maingueneau, D., *Aborder la linguistique*, Edition du Seuil, 2009.
- Mebiane-Akono, P., *De la linguistique aux sciences du langage*, L’Harmattan, 2009.
- Moeschler, J., et Auchlin, A., *Introduction à la linguistique contemporaine*, Armand Colin, deuxième édition, Paris, 2000.
- Përnaska, R., Plangarica, T., *Luigj-Lysjën Bonaparti – gjuhëtari që vëzhgoi, përqasi e dëshmoi edhe për gjuhën shqipe dhe të folmet e saj*, në Aktet e Konferencës Ndërkombëtare “Studimet Albanistike në Itali”, të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2019, 22-23 tetor, Prishtinë 2020, faqe 303-314.
- Plangarica, T., *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*, Sejko, 2002.
- Rastier, F., *Saussure au futur*, Editions Les Belles Lettres, Collection “encre marine”, 2015.
- Robins, R.H., *Brève histoire de la linguistique*, Paris, Editions du Seuil, 1976.
- Sasseville, M., *La théorie logique d’Aristote et la pratique des arts libéraux*, in “Laval théologique et philosophique”, 55 (2), 1999, 285-307 (en ligne [erudit.org/fr/](http://erudit.org/fr/)).



- Saussure, F. (de), *Écrits de linguistique générale*, Paris, Gallimard, 2002 [éd. Simon Bouquet et Rudolf Engler].
- Sériot, P., La langue pense-elle pour nous? Et La linguistique aujourd'hui, Reactions in "La linguistique aujourd'hui, Fondement & domaines.", volume 49, fascicule 1, 2013, Presses Universitaires de France, Paris, page 115-131; 195-204.
- Slama-Cazacu, T., *Linguistique appliquée: une introduction*, La scuola, 1984.
- Soutet, O., *Linguistique*, PUF, Quadrige, 2011, 2-ème édition.
- Stegu, M., La linguistique appliquée: discipline ou groupement de disciplines indépendantes? In "Histoire Epistémologie Langage", tome 33, fascicule 1, 2011, page 129-139.

## SUMMARY

### ON THE RELEVANCE AND NATURE OF THE APPLIED LINGUISTICSSCHOLARLY CONTRIBUTIONS TO THE SPEECH SCIENCES

This article aims at introducing data, explanations and interpretations concerning the nature of the scholarly contributions in a particular field of linguistics, namely the applied linguistics, and the status of this discipline within the framework of the speech sciences nowadays. Based on the studies and experiences already obtained in the European linguistic thought and beyond, applied linguistics is viewed as a discipline included in the speech sciences but also as a discipline *par excellence* for a number of reasons: it is a new discipline, lately institutionalized in the linguistic thought, but at the same time it was present as an internal tendency and need of the linguistic reviews of all times; applied linguistics is an autonomous discipline and at the same time is a (meta-) discipline which includes a number of (sub-) disciplines related to speech and language; it is an applied discipline which however processes linguistic theories in order to analyse various profiles in its studies' objective; its research aims at solving issues that the today's society encounters when using language in communication.

In order to point out the particularities of this field of study, the epistemological context in which this scholarly discipline is constructed, and the aim of its study objective, concepts and methodology followed, the article focuses on the following issues: the character of the insight obtained by the linguistic theoretical and applied disciplines and from this point of view, the distinction between the knowledge obtained in linguistic theoretical disciplines from those in applied linguistics; the tradition inherited in the implementation of the linguistic knowledge before the institutionalisation of the applied

linguistics and in addition, the criteria for the inclusion of the linguistic knowledge in applied linguistics; the more direct epistemological context in which the applied linguistics has been institutionalised (meaning the cognitive and social institutionalisation of this discipline) and the specification of its study objective; the rush developments and the abundant scientific contributions from the experiences gained in different countries and the specific issues in the respective countries as a result of the peculiarities of social developments and the demands of the social environment towards linguistics.

In this article are assessed the (chronological) contributions to this discipline in Albanian linguistics and is particularly underlined the need for a deeper analysis in a number of fields among which: teaching and learning languages (and closely related to it, studies of the speech sciences on the Albanian phenomena and their use in various communicative situations); in the field of translation, not only that of artistic literature but also in other fields of social activity; in the field of terminology which requires a great deal of work and study in these times of hasty developments in science and technology; in the field of language information processing, in order to draft and regulate the data of spoken Albanian corpus, and likewise the drafting of electronic dictionaries of various character (giving the necessary priority to the preparation of electronic grammar and spelling checkers as a means in the everyday use of Albanian); in the field linguistic data reviewing for “professional languages” and speeches in specific working sectors according to professions and different professional groupings; in the field of linguistic statistics and processing of linguistic data for different subsystems of Albanian; in the field of study that deals with pathologies and speaking disorders in specific age-groups, etc. Deeper studies and practical solutions proposed in these fields would enable further steps towards cognitive institutionalisation of this subject in Albanian linguistics. In addition, the article stresses the need for a fuller social institutionalisation of this discipline in the Albanian scientific environment, which means the institutional representation of the scientific community of this field of study through the establishment of associations or research centres for the Albanian applied linguistics according to already successful models that function in many countries across the world, and the membership of this association in *the International Association of Applied Linguistics* (the French acronym is *AILA* for - *Association Internationale de Linguistique Appliquée*); the publication of a specialised periodical, that is a journal (or journals) which would continuously promote the results of the scientific work of the scholarly community (which may include not only linguists but also various scholars, specialists, engineers, technicians, IT professionals who work in the fields of programming and information and

technology communication); in addition is strongly suggested the establishment and promotion of applied linguistics departments in Albanian universities, etc.

Overall, the article emphasises the idea that fields of research and study such as applied linguistics are initiated and developed first and foremost by the everyday need of people to achieve communication. The delay or slow pace in the development of the applied linguistics has a direct influence in the present and certainly on the future of different individuals and social communities, due to the peculiar nature of the questions dealt with and the character of its outcomes and contributions. Therefore, even in the Albanian scholarly thought, the pace of development of applied linguistics must be estimated considering the functions that it has/must have, and the particularity of its social utility.

